

Libri i

TEUHIDIT DHE AKIDES

Shejkhul Islam Muhammed Bin Abdul-Dehabi

Nga: Shejkh Hejthem Serhan



Libri i Teuhidit dhe Akides

مَعْرِفَةُ الْإِلَهِ وَالْعَقِيدَةِ

Shejkhu i nderuar:
Hejthem Serhan



Tri parimet

Katër rregullat

Mësimet të rëndësishme

الأصول الثلاثة

القواعد الأربع

الدروس المهمة




Mblodhi dhe përktheu:
Firdeus Ilir Çorja





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Hyrja

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë, prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje të mëkateve, tek Ai mbështetemi të na ruajë nga sherri i vetes sonë dhe nga të këqijat e punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humb dhe atë që e humb Allahu nuk ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut një e të vetëm, dhe se Muhammedi ﷺ është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.

Nuk ka dyshim se mësimi, puna dhe thirrja në realizimin e teuhidit dhe distancimi prej shirkut dhe pasuesëve të tij, është obligimi më i madh me të cilin Allahu i urdhëroi robërit e Tij. Kjo ishte thirrja e profetëve, prej të parit Nuhut عليه السلام deri tek i fundit, vula e profetëve Muhammedi ﷺ.

﴿لَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾

Vërtet Ne tek çdo popull çuam të dërguar (që u thonin atyre): “Adhurojeni Allahun dhe shmanguni prej (largohuni) idhujve!” (En Nahl: 36)

Profeti ﷺ, përgjatë trembëdhjetë viteve te tij ne Mekke, nuk rreshti së thirruri në teuhid. Po ashtu gjëja e parë të cilën ndërmorri mbas çlirimit të Mekkes ishte thyerja e idhujve.

Teuhidi ka një rëndësi të veçantë në fenë islame, prandaj e pamë të arsyeshme përgatitjen e një materiali sado modest që ka të bëjë me këtë lëmi.

Ky material është përpiluar nga shejkhu i nderuar **Hejthem Sarhan** (Allahu e ruajtë), duke na servirur dhe qartësuar disa prej librave esencial që duhet të studiojë çdo musliman.

E lusim Allahun e Lartëmadhëruar me Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tij të larta, që ta bëjë këtë vepër vetëm për hir të Tij.¹

¹Përkthyesi.

Edukata e nxënësit të dijes



❁ Me veten e tij :

Në vijim do shpalojmë disa tipare, cilësi me të cilat duhet të vishet nxënësi i dijes. Edukata e nxënësit të dijes duhet të vërehet në këto aspekte:

Dija është adhurim, andaj veshja me petkun e dijes, kërkimi dhe praktikimi i saj duhet të jetë i singertë dhe njëkohësisht të jetë në përpuethshmëri me traditën profetike.

Të qenurit selefij i përpiktë, frikë-respekti ndaj Allahut, përmirësimi i vetvetes, thjeshtësia, largimi i kryeneçësisë dhe kundërshtimi i mendjemadhësisë, të qenit të kënaqur me aq sa të është dhënë, asketizmi, burrëria (*të ruhesh nga ato gjëra që ta prishin atë*), shfaqja e cilësive burrërore, braktisja e kënaqësive të kësaj bote, largimi nga vendet e padobishme, pajisja me butësi, palëkundshmëria dhe qëndrueshmëria. Vullneti dhe etja në kërkimin e dijes, udhëtimi në kërkim të saj, shkruarja e dijes, përsëritja e gjërave të mësuara më parë, kërkimi i mbrojtjes dhe strehimit tek Allahu, saktësimi i dijes.


Mburoja e nxënësit të dijes është fjala: *nuk e di!*

Të tregojë kujdes për kohën, e cila është pasuri mjaft e madhe, në përdorimin e saj për lexim, saktësimi dhe përforcimi të dijes së marrë si dhe në shfletimi i librave voluminoz. Gjithashtu e rëndësishme është aftësia në bërjen e pyetjes, dëgjimi, kuptimi, e më pas praktikimi i saj.

Të debatojë pa armiqësi, të përsërisë dijen e marrë, të kapet fort pas Kur'anit, sunnetit dhe shkencave që lidhen me to, të plotësojë (përforcojë) themelet në çdo fushë, të largohet nga dashuria për tu dukur dhe për tu njohur në këtë botë, ta kritikojë vetëpëlqimin dhe të mendojë mirë për njerëzit.

Zekati i dijes: Të thotë të vërtetën, të jetë urdhërues në të mirë dhe ndalues i të keqes, të jetë ekuilibruar midis dobisë dhe dëmeve, të përhapë dijen, të dojë dobinë, dhe të kontribuojë me pozitën që ka në mënyrë që të bëjë ndërmjetësim të mirë për muslimanët që u kanë rënë sprova (*probleme*).

Krenaria, mbrojtja dhe ruajtja e diturisë, përdorja e urtësisë dhe jo servilizmi, lënia e tealumit (*të pretendojë personi që ai është dijetar dhe në të vërtetë nuk është ashtu*), të folurit për atë që nuk është kompetent, qëndrimi i nxënësit të dijes ndaj gabimit të një dijetari, kundërshtimet midis dijetarëve, kundërpërgjigja ndaj dyshimeve, largimi nga grupacionet dhe partitë gjithashtu mosbërja miqësi dhe armiqësi për hir të tyre .



✿ Në dije:

Ti marrë gjërat gradualisht, të fillojë me më të rëndësishmen, të pyes dijetarë e jo nxënës dije, të mësojë një tekst të shkurtër dhe ta përforcojë atë tek një dijetar i përpiktë, dhe të mos angazhohet me libra të gjatë ndërkohë që nuk ka përsosur bazat, të mos hidhet nga një fushë dije tek tjetra para se ta mbarojë të parën, të piketojë dobitë dhe rregullat në dije, të mos studiojë më shumë se një dituri në mënyrë që të mos i përzihen.

✿ Me mësuesin:

Respekti ndaj mësuesit duke mos e tepruar apo neglizhuar një gjë të tillë, të jetë shembull i mirë tek ai, të përqendrohet tek fjala e tij, të shkruajë gjatë kohës së mësimit dhe ta përsërisë atë, te gjejë kohën e përshtatshme për të pyetur mësuesin dhe jo kur ai është i zënë, shkruajtja e tekstit të incizimeve dhe dëgjimi i tyre.

Kujdes marrjen e dijes nga bidatçiu, dhënia rëndësi dijes dhe jo shoqërisë.

Lidhja me Krijuesin e tij pasi ashtu si të jemi ashtu dhe do të jenë edhe prijësit tanë.

✿ Me shokun:

Të tregojë kujdes nga shoku i keq, besimtari është pasqyrë për vëllain e tij, të bashkëpunojë dhe të studiojë/përsërisë me të, të këshillohet me te, te mbulojë mangësitë e tij, te mos përhapë sekretet e tij, te mos mbarte fjalë nga një palë tek një palë tjetër.


Kujdes nga: përgojimi, shakatë e shumta, ndërhyrja mes dy vetave kur diskutojnë, urrejtja, smira, mendimi i keq, shoqërimi me bidatçitë, përmendja e fitneve me qëllim mbrojtjen prej tyre.

✿ Me librat:

Të marrë librat bazë, të mos e mbushë librarinë tij dhe mos hutohet me libra dytësor (të ulët) sidomos librat e bidatçive dhe librat e fitneve dhe dyshimeve, të kapet pas librave të imamëve siç janë, Shejkhul Islami: Imam Ibn Tejmijje dhe Imam Ibn Kaj-jimi (Allahu i mëshiroftë), si dhe dijetarët e davetit (*ata janë Muhammed Ibn AbdulUehhabi dhe të tjerët pas tij [Allahu i mëshiroftë]*), mos të marrë libra për të këshilluar ndonjë shejkh se kjo ndoshta nuk është gjë e mirë për të, mos të përfitojë prej një libri pa i njohur termat që përdor përpiluesi i tij, dhe mos të jetë qëllimi tij mbledhja e librave dhe mbajtja e tyre në bibliotekë.

✿ Me ambientin në të cilin mëson:

Ta bëjë vendin ku qëndron të mbushur plot me përmendje ndaj Allahut dhe veçanërisht xhamijat, sepse ato nuk janë ndërtuar që të bëhet tregti në to apo për kërkimin e gjërave të humbura.







Shejkh Hejthem Serhan

Shpjegimi i:


Tri Parimeve

شرح أصول الثلاثة






Tri parimet (Shkurtimisht ato janë pyetjet e varrit).	Katër çështje për të cilat e obligohet njohja dhe argumentimi i tyre (surja Asr)	Dija është njohja e: Allahut, të Dërguarit të Tij dhe Fesë Islame me argumente.	
		Të punuarit me këtë dije: Dija ka nevojë që të vihet në praktikë, përndryshe ajo humbet.	
		Thirrja për tek kjo dije :	Kushtet e thirrjes: Singëriteti, dituria fetare, njohja e gjendjes dhe situatës së atij që thërret, urtësia, durimi.
			Gjëja e parë me të cilën fillon thirrja islame është <i>teuhidi</i> (monoteizmi, njëshmëria) dhe <i>mohimi i idhujtarisë</i> (shirkut), kjo ishte thirrja e profetëve.
	Durimi :	☞ Në bindje ndaj Allahut, siç është : namazi, agjërimi ☞ Ndaj mëkateve : kamata, zinaja ☞ Ndaj sprovave të kaderit (caktimit) : varfëria, sëmundja	
		Ka pas për qëllim autori me durimin ndaj: dijes, të punuarit me të dhe thirrjes për te kjo dije.	
Tri parimet (Shkurtimisht ato janë pyetjet e varrit).	Tri çështje për të cilat obligohet njohja dhe argumentimi i tyre	Teuhidi rububije: Kur Allahu veçohet me Zotërim, atëherë Ai patjetër duhet të veçohet në adhurim.	
		Singëriteti (teuhidi uluhije) : Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet Atij shokë në adhurim, qoftë ai engjell i afërt apo i dërguar.	
		Miqësia dhe armiqësia: Distancimi prej shirkut dhe pasueseve të tij, e kjo aplikohet me: <i>Zemër</i> (urrejtje), <i>gjuhë</i> (<i>unë jam i pastër nga ajo që ju adhuroni</i>), <i>gjymtyrë</i> (mos marrja pjesë në: Festat, mbledhjet e tyre dhe mos veshja e rrobave të tyre).	
Tri parimet (Shkurtimisht ato janë pyetjet e varrit).	Shkaqet për të cilat mësojmë Teuhidin	Allahu ka urdhëruar Profetët dhe të gjithë njerëzit që ta adhurojnë Atë të vetëm dhe të shmangen prej shirkut (idhujtarisë), ky pra është qëllimi i krijimit të tyre. Çështja më madhore për zbatimin e secilës Allahu i Lartësuar ka urdhëruar është teuhidi (njësimi); të veçuarit e Allahut në adhurim . Ndërsa çështja më të madhore prej secilës Allahu i Madhëruar na ka ndaluar është shirku (shokvënia); të lutësh dikë tjetër bashkë me Allahun . Nuk ka diçka më të dobishme për zemrën se sa teuhidi dhe singëriteti në fenë e tij, si dhe nuk ka diçka më të keqe për zemrën se sa shirku (idhujtaria). Për këtë Allahu ka dërguar Profetët, si dhe ka zbritur Librat, pra me realizimin e teuhidit shlyhen mëkatet, me të e ke të garantuar xhenetin, e me të shpëton nga zjarri , si dhe asnjë vepër nuk pranohet vetëm se me teuhid.	
		Teuhid është shkak për: zgjerimin e gjoksit duke e mbushur atë me iman, qetësi dhe udhëzim, siguri dhe qëndrueshmëri, poashtu përfitimin e ndërmjetësimit të Profetit ﷺ. Nuk ka diçka më të mirë që mund t'i largoj mundimet e dynjasë se sa Teuhidi.	



Tri parimet	Njohja e Allahut të lartëmadhëruar. Kush është Zoti yt ? Si e njohe Zotin tënd ? Zoti është ai i cili duhet të adhurohet, llojet e adhurimeve, gjykimi për atë i cili vepron ndonjë adhurim për dikënd tjetër përveç Allahut, duke përmendur argumentet përkatëse.		
	Njohja e fesë Islame me argumente, përkufizimi i Islamit, kategoritë e fesë, shtyllat e islamit, përkufizimi i shehadetit (dëshmisë), shtyllat e besimit, degëzimet e besimit, ihsani-bamirësia e përsosur, argumentet për kategoritë e fesë, shenjat e kiametit.		
	Njohja e Profetitﷺ : Prejardhjen e tij, vendlindjen, lindjen, moshën, profetsinë dhe mesazhin me të cilin ka ardhur, urtësinë në dërgimin e tij, sa kohë thirri ne teuhid, Israi dhe Miraxhi, ku dhe kur u obligua namazi, hixhreti (<i>Migrimi</i>) dispozita e tij dhe koha kur ka ndodhur, kur janë obliguar legjislacionet e tjera islame. Kohëzgjatja e thirrjes, çfarë pruri nga feja, vdekja e tij.		
Konkluzioni :	Llojet e xhihadit :	Ndaj vetes	Me suren Asr:(Dija, puna me të, thirrja në këtë dije, durimi).
		Me, ndaj shejtanit	<u>Epsheet (shehauat)</u> Mëkatet e mëdhaja: Për të cilat ka dënim të caktuar. Mëkatet e vogla: Çdo e ndaluar për të cilën nuk ka dënim të caktuar.
			<u>Dyshimet (shubuhat):</u> 1. Shirku i madh (i cili të nxjerr nga feja). 2. Shirku i vogël. 3. Bidati (risitë).
			Me jobesimtarët dhe hipokritët
	Et- tagut	Fjala tagut rrjedh nga fjala tug-jan, që do të thotë tejkalim kufijsh, ndërsa terminologjikisht: Tagut: Është për cilindo ndaj të cilit robi i kalon kufijtë duke: ☞ e adhuruar atë (<i>pemë apo gurë</i>), ☞ e ndjekur (<i>njerëzit e prishur Ulemau Su</i>), ☞ apo duke i`u bindur atij (<i>prijësit që ka dalë jashtë bindjes së Allahut</i>). Tagutët janë të shumtë, porse prijësit e tyre janë pesë: Iblisi, kushdo që adhurohet dhe është i kënaqur me atë adhurim, kushdo që i thërret njerëzit që ta adhurojnë atë, kushdo që pretendon se ka ndonjë farë dije mbi të fshehtën (gajbin) dhe kushdo që gjykon me tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu.	
Allahu e di më së miri, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi profetin Muhammed dhe te gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij.			





El Hanifijeh është feja e pastër prej shirkut (idhujtarisë) dhe e ndërtuar mbi teuhidin dhe singëritetin.

Teuhid nga ana gjuhësore do të thotë: Të veçosh diçka nga një tjetër.


Ndërsa nga ana terminologjike: Njësimi i Allahut të Lartësuar me atë që i takon Atij prej zotërimit, adhurimit, Emrave dhe Cilësive të Tij të bukur.

Shirku është lutja e dikujt tjetër përveç Allahut krahas Tij, e ky është mëkati më i madh mbi sipërfaqen e tokës.


- ❧ Përse e mësojmë Teuhidin ?
- ❧ Përse i mësojmë Tri Parimet ?
- ❧ Cilat janë Tri Parimet, shkurtimisht ?
- ❧ Çfarë dobie ka mësimi i Tri Parimeve ?
- ❧ Çfarë të veçante kanë librat e Imamit Muhammed ibn AbdulUehab ?
- ❧ Për çfarë arsye e kanë akuzuar atë ?
- ❧ Si duhet t'i përgjigjemi këtyre akuzave ?

ﷻ = (Paqja qoftë mbi të!)



ﷻ = (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)




Thojat e lutjes (du'a)





Thojat e frikës (el-khauf)



Lojet e kurbanit (dhebbh)



Lojet e zotimit (nedhr)



Shpjegim i shtyllave të besimit



Besimi: Është fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe veprim me gjymtyrë, shtohet me punë të mira dhe pakësohet me mëkate.

✽ Besimi në Allahun:

1. Besimi në ekzistencën e Allahut:

☞ *Logjika*

☞ *Të dhënat shqisore*

☞ *Natyrshmëria*

☞ *Legjislacioni fetar*

2. Besimi në teuhidin rububije (njësimi i Allahut me veprat e Tij).
3. Besimi në teuhidin uluhije (veçimi i Allahut në adhurim).
4. Besimi në teuhidin esma ue sifat (besimi në Emrat dhe Cilësitë e Allahut).

✽ Besimi në engjëjt e Tij:

Ata i ka krijuar Allahu prej drite dhe i përkasin botës së fshehtë (gajbit), i binden Atij dhe nuk i shkelin urdhërat e Tij, kanë shpirtra, trupa, logjikë dhe zemra.

“Derisa të largohet frika nga zemrat e tyre”.


Ne besojmë në atë që na ka lajmëruar Allahu prej, emrave, cilësive, dhe punëve të tyre.

✽ Besimi në librat e Tij:

Besojmë se ato janë fjalët e Allahut, janë shpallje prej Zotit të botrave dhe jo të krijuar, Allahu për secilin profet ka zbritur libër. Besojmë në gjithçka që na ka lajmëruar Allahu prej: Emrave, lajmeve të tyre dhe dispozitave, dhe me të vërtetë Kur`ani është shfuqizuesi i librave që erdhën para tij.

Disa prej tyre:

- ☞ Fletushkat e Ibrahimit dhe Musait.
- ☞ Zeburi.
- ☞ Teurati.
- ☞ Inxhili.
- ☞ Kur`ani.



✽ Besimi në të dërguarit e Tij:

Besojmë se ata janë njerëz dhe nuk posedojnë asgjë nga çështjet e Zotërimit, se janë robër të Allahut që nuk adhurohen, se ata nuk gënjën apo flasin nga dëshira e tyre për atë çka janë dërguar. Ata përcollën atë që ju zbreti Allahu në mënyrë të qartë, e kryen amanetin e tyre, e këshilluan popullin, luftuan në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë. Besojmë në ato që na ka treguar Allahu prej: Emrave, cilësive, dhe lajmeve të tyre.

Profeti i parë është Nuhu عليه السلام, ndërsa vula e të dërguarve dhe i profetëve është Muhammedi ﷺ, dhe të gjitha legjislacionet e mëparshme janë shfuqizuar me atë të profetit Muhammed ﷺ.


✽ Besimi në ditën e fundit:

Besimi në ditën e fundit përfshin çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes për të cilën na ka lajmëruar profeti ﷺ, siç janë: Shenjat e ditës së gjykimit, sprova e varrit, fryrja e bririt (*sur*), ringjallja e njerëzve prej varreve të tyre, peshorja e veprave, librat që do t'i jepen çdo njeriu me veprat e tij, ura e siratit, el-haud (lumi), shefati (ndërmjetësimi), xheneti, zjarri.

✽ Besimi në Kaderin (caktim) për të mirë apo për të keq:

Ai ndahet në katër shkallë:

- ☞ **Dija (*el-ilm*):** Besimi se Allahu i Lartëmadhëruar di çdo gjë, qoftë ajo gjithëpërfshirëse apo e detajuar.
- ☞ **Shkrimi (*el-kitabeh*):** Besimi se Allahu ka shkruajtur caktimin e çdo gjëje në (Leuhi Mahfudh, Libri i ruajtur tek Allahu) deri sa të vijë ora e fundit (kijameti).
- ☞ **Dëshira (*el-mesh'ijeh*):** Besimi që çdo gjë që dëshiron Allahu ekziston dhe çdo gjë që nuk ekziston nuk e dëshiron Allahu. Dhe njeriu ka dëshirë, porse kjo dëshirë e tij është nën dëshirën e Allahut.
- ☞ **Krijimi (*el-khalk*):** Besimi se të gjitha krijesat janë të krijuara nga Allahu, me qënien, cilësitë dhe lëvizjet e tyre.





Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab

Tri Parimet

الأصول الثلاثة

Përktheu tekstin: Xhabir Sheme



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!

Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë mbi ne që t'i mësojmë katër çështje:

- ✽ E para: **Dija**, ajo është njohja e Allahut të Madhëruar, njohja e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) si dhe njohja e fesë islame me argumente.
- ✽ E dyta: **Të punuarit me këtë dije**.
- ✽ E treta: **Thirrja për tek kjo dije**.
- ✽ E katërta: **Durimi** ndaj dëmeve që mund të ndodhin gjatë kësaj thirrjeje.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿وَالْعَصْرِ ۝١ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ۝٢ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ۝٣﴾

“(Betohem) për kohën! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, dhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe të jenë të durueshëm.” [El Asër, 1-3].


Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Sikur Allahu i Madhëruar të mos zbriste argument tjetër për krijesat e Tij vetëm se këtë sure, kjo do t’u mjaftonte atyre.”

Buhariu ka thënë: Kapitulli: “Dija para fjalës dhe punës”. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ﴾

“Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar të vërtetë pos Allahut, dhe kërko falje për mëkatin tënd.”
[Muhammed, 19].

Pra, Allahu i Madhëruar e nisi me dijen para fjalës dhe punës.



Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë për çdo musliman dhe muslimane që t'i mësojë tri çështje si dhe të punojë me to:

- ✽ **E para:** Allahu i Madhëruar është Ai i Cili na ka krijuar, Ai është Furnizuesi ynë dhe nuk na la në shpërkujdesje por na dërgoi të dërguar. Kush i bindet (përgjigjet) thirrjes së tij do të hyjë në xhenet ndërsa kush e kundërshton atë (nuk i bindet) do të hyjë në zjarr. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ رَسُولًا ۖ فَعَصَىٰ فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ ۖ فَأَخَذْنَاهُ أَخَذًا وَبِيلًا ۖ ﴾

"Ne dërguam te ju të dërguar që dëshmon kundër jush, ashtu siç patëm dërguar edhe te faraoni të dërguar. E faraoni e kundërshtoi të dërguarin, andaj Ne i dhamë atij një dënim të rëndë."
[El Muzemil, 15-16].

- ✽ **E dyta:** Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet Atij shok në adhurim, qoftë ai engjell i afërt apo i dërguar. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar :

﴿ وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا ۖ ﴾

"Dhe vërtet xhamitë janë veçantë për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!" [El Xhinë, 18].

- ✽ **E treta:** Me të vërtetë kush i bindet të Dërguarit dhe e njëson Allahun e Madhëruar, nuk i lejohet atij që t'i dojë ata të cilët e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe nëse (ai kundërshtuesi) është prej njerëzve më të afërm. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَٰئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُمْ بِرُوحٍ مِّنْهُ وَيَدْخُلُهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ أُولَٰئِكَ حِزْبُ اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ۖ ﴾

“Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhennete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty janë, përgjithmonë. Allahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e Allahut, ta dini pra, se ithtarët e Allahut janë ata të shpëtuarit.” [El Muxhadileh, 22].

Dije, Allahu të udhëzoftë në bindjen ndaj Tij, Me të vërtetë **El Hanifijjete** është feja e Ibrahimit (alejhi selam): **Të adhurosh Allahun Një e të vetëm duke ia përkushtuar fenë vetëm Atij**. Me këtë gjë (besimin e pastër Islam në Një Zot të vetëm) Allahu i Madhëruar i urdhëroi të gjithë njerëzit, e për këtë arsye i krijoi ata. Siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë Mua.”

[Edh Dharijat, 56].


“Të më adhurojnë Mua” d.m.th. të më njësojnë.

Çështja më madhore për zbatimin e së cilës Allahu i Lartësuar ka urdhëruar është **teuhidi** (njësimi); të veçuarit e Allahut në adhurim. Ndërsa çështja më madhore prej secilës Allahu i Madhëruar na ka ndaluar është **shirku** (shokvënia); të lutësh dikë tjetër bashkë me Allahun. Argument për këtë është Fjala e Allahut, Një e të vetëm:

﴿وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا﴾

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë.” [En Nisa, 36].

Nëse ty të thuhet: **Kush janë tri parimet, njohjen e të cilave çdo njeri e ka obligim?** Thuaj: Njohja nga ana e robit (njeriut) Zotin e tij, fenë e Tij, si dhe njohja e të Dërguarit të Tij, Muhammedit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*).



Parimi i parë



❖ Nëse ty të thuhet: **Kush është Zoti yt?**

Thuaj: Zoti im është Allahu, i Cili përkujdeset për mua si dhe për të gjitha krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i Adhuruari im, dhe unë nuk kam të adhuruar tjetër përveç Tij. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

"Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve." [El Fatiha, 1].

Çdo gjë tjetër përveç Allahut të Madhëruar është krijim i Tij. Unë jam njëri prej krijesave të Tij.

❖ Nëse ty të thuhet: **Si e njohe Zotin tënd?**

Thuaj: Me anë të argumenteve dhe me anë të krijesave të Tij. Prej argumenteve të Tij është: Dita dhe Nata, Dielli dhe Hëna.

Ndërsa prej krijesave të Tij: Shtatë qiejt dhe shtatë tokat dhe çfarë ka në brendësi dhe ndërmjet tyre. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي

﴿خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ﴾


"Dhe prej argumenteve të Tij janë nata dhe dita edhe dielli dhe hëna. Mos u bini në sexhde as diellit e as hënës, por bini në sexhde vetëm ndaj Allahut i Cili i krijoi ato, nëse jeni vërtet që e adhuronit Atë." [Fusilet, 37].

Gjithashtu Fjala e Tij:

﴿إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَى عَلَى الْعَرْشِ يُغْشَى اللَّيْلَ النَّهَارُ

﴿يَطْلُبُهُ حَيْثُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ مُسَحَّرَاتٍ بِأَمْرِ رَبِّهِ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾

"Vërtet që Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj Ai Isteva (u ngrit lart e qëndroi mbi) Arsh. Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pandërprerë. Ai krijoi edhe diellin, edhe hënën, edhe yjet të nënshtruar ndaj urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është krijimi dhe komandimi. I Lartësuar qoftë Allahu, Zoti i aleminit." [El Araf, 54].



Zoti është Ai i Cili meriton të adhurohet me të drejtë. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar :

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾﴾ البقرة: ٢١ - ٢٢

“O njerëz! Adhuroni Allahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar. I Cili e ka bërë tokën vend pushimi për ju dhe qiellin me kupë si mbulesë duke dërguar që andej ujë për të prodhuar fruta si furnizim për ju. Atëherë pra, mos i vini shok Allahut (në adhurim) kur ju e dini.” [El Bekare, 21-22].

Ibën Kethiri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Krijuesi i këtyre gjërave, Ai është i Cili e meriton adhurimin.”

Prej llojeve të adhurimit me të cilat Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar përmendim: **Islami, Besimi dhe Ihsani**. Po ashtu prej tyre: Lutja, frika, shpresa, mbështetja, dëshira, frikrespekti, nënshtrimi, druajtja, të kthyerit tek Allahu, kërkimi i ndihmës, kërkimi i mbrojtjes, përgjërimi, bërja kurban, en nedhru (përmbushja e zotimit) si dhe të tjera adhurime për të cilat Allahu ka urdhëruar. Pra, që të gjitha këto janë vetëm për Allahun e Madhëruar.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا ﴿١٨﴾﴾

“Dhe vërtet xhamitë janë veçant për ta adhuruar Allahun, e mos adhuroni në to askënd tjetër me Allahun!” [El Xhinë, 18].

Kush kryen ndonjë nga këto për tjetërkënd përveç Allahut, atëherë ai është mushrik-kafir. Argument për këtë është Fjala e Allahut:

﴿وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ ﴿١٧﴾﴾

“Dhe kushdo që lut (ose adhuron) në vend të Allahut çdo zot tjetër për të cilin nuk ka asnjë provë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet që jobesimtarët nuk do të kenë kurrë sukses.” [El Muminun, 11].

Argument nga hadithi:

« الدعاء مخ العبادة »

“Duaaja (lutja) është truri i adhurimit”

Po ashtu Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ﴾ (٦٠)

“Dhe Zoti juaj thotë: “M’u lutni Mua, Unë do t’ju përgjigjem. Me të vërtetë se ata të cilët e përbuzin adhurimin ndaj Meje, ata padyshim që do të hyjnë në xhehenem me poshtërim!” [El Gafir, 60].

❖ Argumenti për **frikën** (الخوف) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴾ (١٧٥)

“Kështu që, mos iu frikësoni atyre aspak, por m’u frikësoni vetëm Mua, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” [Al Imran, 175].

❖ Argumenti për **shpresën** (الرجاء) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا ﴾ (١١٠)

“E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd.” [El Kehf, 110].

❖ Argumenti për **mbështetjen** (التوكل) është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴾ (٢٣)

“Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë.” [El Maide, 23].

Po ashtu Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ ﴾

“Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij.” [Et Talak, 3].

- ❖ Argumenti për **dëshirën** (e cila është e shoqëruar më shpresë) (الرغبة),
frikrespektin (الرهبه) dhe **nënshttrimin** (الخشوع) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْكَرُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَكَ رُغْبًا وَرُهْبًا وَكَانُوا لَنَا خَلِيعِينَ ۝۹۰﴾

"Ata vërtet ishin që nxitonin të bënin punë të mira dhe gjithnjë na luteshin Neve me shpresë dhe frikë, dhe gjithnjë nënshtroheshin ndaj Nesh." [El Enbija, 90].

- ❖ Argumenti për **druajtjen** (الخشية) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِ﴾

"Kështu që, mos iu druani atyre, por m'u druani vetëm Mua!" [El Bekare, 150].

- ❖ Argumenti për të **kthyerit tek Allahu** është (الإنابة) Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿وَأَنِيبُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلُمُوا لَهُ﴾

"Dhe kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojuuni Atij." [Ez Zumer, 54].

- ❖ Argumenti për **kërkimin e ndihmës** (الإستعانة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ۝۱﴾

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë." [El Fatiha, 1].

Ndërsa në hadith thuhet:

« إِذَا اسْتَعْنَتْ فَاسْتَعْنِ بِاللَّهِ »

"Nëse kërkon ndihmë kërko vetëm nga Allahu."

- ❖ Argumenti për **kërkimin e mbrojtjes** (الإستعاذة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ١ ﴾

"Thuaj: "Mbrohëm (me Allahun) Zotin e agimit." [El Felek, 1].

﴿ قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ١ ﴾

"Thuaj: "Mbrohëm (me Allahun) Zotin e njerëzve." [Nas, 1].

❖ Argumenti për **përgjërimin** (الإستغاثة) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَبَ لَكُمْ ٩ ﴾

"(Përkujtoni) kur ju kërkuat ndihmë me përgjërim te Zotit tuaj dhe Ai u përgjigj." [El Enfal, 9].

❖ Argumenti për **bërjen kurban** (الذبح) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ قُلْ إِنْ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ١٦٦ لَا شَرِيكَ لَهُ. وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ ١٦٧ ﴾

"Thuaj: "Sigurisht falja ime, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok e të barabartë me Të." [El Enam, 162-163].


Ndërsa nga hadithi:

"E mallkoftë Allahu atë i cili ther për tjetër kënd përveç Allahut."

❖ Argumenti për **en nedhru** (përmbushjen e zotimit) (النذر) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ يُوفُونَ بِالنَّذْرِ وَيَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا ٧ ﴾

"Ata (janë të cilët) përmbushin betimet (e tyre) dhe i frikësohen një Dite, e keqja e së cilës ka përmasa të mëdha." [El Insan, 7].



Parimi i dytë



- ✿ **Njohja e fesë islame me argumente** dhe është: *Dorëzimi (nënshttrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshttrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.*

Kjo përmbledh tri kategori:

1. Islami
2. Besimi
3. Ihsani

Dhe secila nga këto kategori ka shtyllat e saj.

Kategoria e parë: Islami

✿ Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut.
2. Falja e namazit
3. Dhënia e zekatit
4. Agjërimi i Ramazanit
5. Bërja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Kabe).

- ❖ Argumenti për **dëshminë** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴾

"Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Fuqplotit e më të Urtit." [Al Imran, 18].

Kuptimi i të cilës është: *Nuk ka të adhuruar tjetër më të drejtë përveç Allahut.*

☞ Me "**La ilahe**" (لا إله) është për qëllim **mohimi** i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut.

☞ Ndërsa "**il lAllah**" (إلا الله) është **pohimi** (me ngulm) se vetëm Allahu është Ai i Cili e meriton adhurimin me të drejtë. Ai nuk ka shok në adhurim ndaj Tij, ashtu siç Ai nuk ka shok në sundimin e Tij.



Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٦٦﴾ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ ﴿٦٧﴾﴾

﴿وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٨﴾﴾

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahim babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, dhe që Ai do të më drejtojë!" Dhe ai (Ibrahimi) e la të përjetshme atë fjalë (besimin në një Zot) ndër pasardhësit e vet, me shpresë që ata të kthehen prej rrugës së gabuar në rrugën e drejtë." [Ez Zuhruf, 26-28].

﴿قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا ٱللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِۦ شَيْئًا

وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ ٱللَّهِ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فَقُولُوا۟ ٱشْهَدُوا۟ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٦٤﴾﴾

" Thuaju: "O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)"! [Al Imran, 64].

❖ Argumenti i pjesës së dytë të dëshmisë: **Dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut**, është Fjala e Allahut të Madhëruar:


﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ

بِٱلْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢٨﴾﴾

"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." [Et Teube, 128].

Kuptimi i dëshmisë: **"Dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut"**:

- ☞ bindja ndaj tij në atë që ai ﷺ ka urdhëruar,
- ☞ të besuarit në atë që ai ﷺ ka lajmëruar,
- ☞ të shmangurit (të larguarit) nga ajo që ai ﷺ ka ndaluar
- ☞ dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe vetëm se me atë që Ai ka ligjëruar.



- ❖ Argumeti për **namazin**, dhënien e **zekatit** dhe shpjegimin i **teuhidit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقِيَمَةِ ۝ ﴾

"Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër, pos asaj që të adhuronin vetëm Allahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç ose përkrah Tij, të kryenin faljen e detyruar të namazit e të jepnin zekatin: dhe kjo është feja e drejtë, e vërtetë." [El Bejjine, 5].

- ❖ Argumenti i **agjërimit të Ramazanit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ۝ ﴾

"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." [El Bekare, 183].

- ❖ Argumenti për **bërjen e Haxhit** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حُجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ ۝ ١٧ ﴾


"Për hir të Allahut, Haxhi është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit te ajo, e kush mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.." [Al Imran, 97]

Kategoria e dytë: Besimi

Besimi ndahet në shtatëdhjetë e disa degë, ku më e larta e saj është fjala **La ilahe il la Allah**, dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga. Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit.

❁ Shtyllat e besimit janë gjashtë:

1. Të besosh në Allahun e Madhëruar
2. Të besosh në engjëjt e Tij
3. Të besosh në librat e Tij
4. Të besosh në të dërguarit e Tij
5. Të besosh në ditën e Fundit
6. Të besosh në paracaktimin e Allahut për mirë dhe për keq.



- ❖ Argumenti për pesë shtyllat e para të besimit është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿لَيْسَ إِلَهٌ إِلَّا أَنَا تَوَلَّوْا وَجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْإِلَهَ مِنْ عِندِ اللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ
وَالْمَلَكُ وَالْكِتَابُ وَالنَّبِيُّنَ﴾

"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tua kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së fundit, engjëjve, librit, pejgamberëve." [El Bekare, 177].

- ❖ Ndërsa argumenti për **paracaktimin e Allahut** është Fjala e Tij:

﴿إِنَّا كُلُّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ﴾

"Ne çdo send kemi krijuar me paracaktim preciz." [El Kamer, 49].

Kategoria e tretë: Ihsani.

Ka vetëm një shtyllë dhe ajo është: *Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty.*

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ﴾ النحل: ١٢٨


"S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës." [El Nahl. 128].

﴿وَتَوَكَّلْ عَلَى الْغَنِيِّ الرَّحِيمِ﴾ (٢١٧) ﴿الَّذِي يَرَبُّكَ حِينَ تَقُومُ﴾ (٢١٨) ﴿وَتَقَلُّبِكَ فِي السَّجْدِ﴾ (٢١٩) ﴿إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾ (٢٢٠)

"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshiruesin e madh, i Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë, (e të sheh) edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen. Në të vërtetë, Ai është Dëgjuesi i çdo gjëje, i Gjithëdijsmi." [Esh Shuara, 217-220].

﴿وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوا مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا﴾

"As ti (o Muhammed) nuk bën ndonjë vepër, as nuk lexon ndonjë pjesë nga Kurani, dhe as ju nuk bëni ndonjë vepër, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë." [Junus, 61].





Argumenti nga suneti.

Hadithi i njohur i Xhibrilit i transmetuar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili ka thënë: Një ditë ishim duke qëndruar me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur na u shfaq një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk dukeshin tek ai gjurmët e udhëtimit dhe askush nga ne nuk e njihte atë. U ul pranë Profetit ﷺ dhe mbështeti gjunjët e tij tek gjunjët e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe vendosi duart te kofshët e tij dhe tha:

"O Muhammed, më trego ç'është Islami?"

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *"Islami është të dëshmuarit se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të kryesh haxhin nëse ke mundësi."*

Tha: **"Të vërtetën ke thënë."**

(Umeri thotë) U habitëm me të, edhe pyet edhe vërteton!

Tha: **"më trego ç'është Besimi (Imani)?"**

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *"Të besosh në Allahun e Madhëruar, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit, si dhe të besosh në paracaktimin e Allahut për mirë dhe për keq."* Tha: **"Të vërtetën ke thënë."**

Tha: **"Më trego për ihsanin."**

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha:

"Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty."

Tha: **"Më trego për Kiametin."**

I Dërguari i Allahut ﷺ tha: *"I pyeturi nuk di më shumë se ai që pyet në lidhje me të!"*

Tha: **"Më trego për shenjat e tij."**


I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: *"Kur të lindë robëresha zonjën e saj, kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e ndërtesave të mëdha."*

Tha (Umeri): Ai u largua ndërsa ne mbetëm të habitur.

I Dërguari i ﷺ tha: *"O Umer, a e di se kush ishte pyetësi?"*

Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së mirë! (i Dërguari i Allahut).

Tha: *"Ai ishte Xhibrili, erdhi që t'ua mësojë çështjet e fesë tuaj."*



Parimi i tretë



❁ Njohja e të Dërguarit tuaj, Muhammedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (Mikut të Allahut). Mbi të dhe mbi të Dërguarin tonë qofshin salavatet dhe selamet më të mira. Ai ﷺ ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare, ku prej tyre 40 vjeç i kaloi para se të bëhej i Dërguar dhe 23 prej tyre i kaloi duke qenë Profet dhe i Dërguar. U bë Profet (*Nebij*) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: "*Lexo!*" dhe u bë i Dërguar (*Resul*) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: "*O ti i mbuluar!*".

Vendlindja e tij është Meka dhe më pas emigroi për në Medine. Allahu i Madhëruar e dërgoi për të tërhequr vërejtjen nga shirku dhe të thërrasë në Teuhid. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿يَا أَيُّهَا الْمَدْيَنِيُّ قُمْ فَأَنْذِرْ ۖ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ ۖ وَبَيْتَكَ فَطَهِّرْ ۖ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ ۚ وَلَا تَمْنُنْ تَسْتَكْثِرُ ۚ﴾

﴿وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ ۚ﴾

"O ti i mbështjellur! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua pastro! Dhe larg nga Er Ruxhz qëndro! Dhe mos jep për të marrë më shumë! Dhe për hir të Zotit tënd, duro!" [El Mudethir, 1-7].


Kuptimi "Ngrihu dhe këshillo!" Është që të tërheqë vërejtjen (të ndalojë) prej shirkut dhe të ftojë për në teuhid (njësimin e Allahut).

"Dhe madhëroje Zotin tënd!" d.m.th. Madhëroje Atë me teuhid (duke e njësuar në të gjitha adhurimet).

"Dhe rrobat e tua pastro!" d.m.th. pastroi punët e tua prej shirkut.

"Dhe larg nga Er Ruxhzu qëndro!" **Er Ruxhz:** Idhujt.

Me qëndrim larg prej tyre është për qëllim braktisja e idhujve dhe idhujtarëve. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kaloi plot dhjetë vjet duke ftuar në teuhid, dhe mbas kësaj u ngrit në qiell dhe u urdhërua me pesë namazet. Mbas kësaj u fal në Meke tri vjet e më pas u urdhërua (nga Allahu) që të bënte hixhret për në Medine.



Hixhreti.

Me hixhretin është për qëllim: *"Migrimi prej vendit të shirkut për në vendin e islamit."* Është detyrë mbi këtë popull (umet) që të bëjë hixhret prej vendit të shirkut për në vendin e islamit. E kjo do të mbesë deri sa të bëhet Kiameti. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّيْنَاهُمُ الْغُلَامَ ظَالِمٍ أَنْفُسِهِمْ قَالُوا فِيمَ كُنْتُمْ قَالُوا كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ فِي الْأَرْضِ قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضَ اللَّهِ وَاسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا فَأُولَٰئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ۝١٧ إِلَّا الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا ۝١٨ فَأُولَٰئِكَ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَعْفُو عَنْهُمْ وَكَانَ اللَّهُ عَفُوًّا غَفُورًا ۝١٩﴾

"Sigurisht për ata të cilët melekët i marrin në vdekje ndërkohë që po i bënin padrejtësi vetvetes së tyre duke qëndruar me jobesimtarët, në një kohë kur shpërngulja ishte e detyrueshme për ta, ata u thonë: "Në çfarë gjendje ishit?" Ata përgjigjen: "Ne ishim të dobët dhe të shtypur në tokë." Melekët u thonë: "A nuk ishte toka e Allahut e gjerë dhe e mjaftueshme për ju për t'u shpërngulur në të?" Njerëz të tillë do ta gjejnë vendbanimin e tyre në xhehenem. Sa përfundim i keq!" Përveç të dobëtve, burra, gra dhe fëmijë, të cilët nuk mund të mendojnë ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë. Dhe Allahu është kurdoherë Falës, gjithnjë Falës i Madh." [El Nisa, 97-99].

Gjithashtu Fjala e Allahut:

﴿يَعِبَادِ الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَاسِعَةٌ فَإِنِّي فَاعِبُدُونِ ۝٥٦﴾


"O robërit e Mi që më besoni! Vërtet që toka Ime është e gjerë. Pra, më adhuron vetëm Mua." [El Ankebut, 56].

El Begauju (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është për muslimanët të cilët nuk u larguan prej Mekës (nuk bënë hixhret). Allahu i Madhëruar i thirri ata në emër të besimit".

Argumenti për hixhretin nga suneti është fjala e të Dërguarit të Allahut ﷺ :

« لَا تَنْقَطِعُ الْهَجْرَةُ حَتَّى تَنْقَطِعَ التَّوْبَةُ، وَلَا تَنْقَطِعَ التَّوْبَةُ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ مِنْ مَغْرِبِهَا »

"Nuk ndërpritet hixhretit derisa të ndërpritet pendimi, dhe nuk ndërpritet pendimi derisa të lindë dielli nga perëndimi."



Kur i Dërguari i Allahut ﷺ u vendos në Medine u urdhërua (nga Allahu i Madhëruar) me plotësimin e sheriatit islam, siç janë: zekati, agjërimi, haxhi, xihadi, ezani, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, si dhe me dispozitat e tjera të fesë islame. Kjo periudhë zgjati dhjetë vjet, e pas kësaj ai ndërroi jetë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të, ndërsa feja e tij mbeti përgjithmonë. Kjo pra, është feja e tij! Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj.

Mirësia të cilën ai ﷺ ia tregoi popullit (umetit) është teuhidi dhe çdo gjë që Allahu i Madhëruar e do dhe është i kënaqur me të, ndërsa e keqja prej së cilës ai ﷺ ndaloi është shirku dhe çdo gjë që Allahu i Madhëruar e urren dhe e refuzon. Allahu i Madhëruar e dërgoi atë ﷺ për mbarë njerëzimin dhe e bëri obligim bindjen ndaj tij për xhindët dhe njerëzit. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿قُلْ يٰٓأَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا﴾

"Thuaj: "O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguar i Allahut." [El Araf, 158].

- ❖ **Allahu i Madhëruar e plotësoi me të (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) fenë.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:


﴿الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا﴾

"Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe." [El Maide, 3].

- ❖ **Argument për vdekjen e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është Fjala e Allahut të Madhëruar:**

﴿إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِنَّهُمْ مَّيِّتُونَ ﴿٣٠﴾ ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخَصُمُونَ ﴿٣١﴾﴾

"Sigurisht që ti do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin, pastaj ditën e Ringjalljes, para Zotit tuaj ju do të haeni e do të kundërshtoheni mes njëri-tjetrit." [Ez Zumer, 30-31].





- ❖ **Të gjithë njerëzit do të vdesin e më pas do të ringjallen.** Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿ مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى ﴾

" Prej asaj (tokës) Ne iu krijuam ju, e ju do t'ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë. " [Ta Ha, 55].

Gjithashtu Fjala e Tij:

وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا ﴿١٧﴾ ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا ﴿١٨﴾

"Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej (dheut të) tokës. Pastaj Ai do t'ju kthejë në të dhe do t'ju nxjerrë prej saj." [Nuh, 17-18].

- ❖ Dhe pas ringjalljes do të llogariten dhe do të shpërblehen për punët e tyre.
Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِيْنَ اَسْتَوٰى بِمَا عَمِلُوْا وَيَجْزِيَ الَّذِيْنَ اَحْسَنُوْا بِالْحُسْنٰى ﴿٣١﴾

"Për t'i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre." [En Nexhm, 31]

- ❖ **Kush e përgenjështon** (mohon) **ringjalljen ai ka bërë kufër**. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:


﴿ زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُغْنِيَ عَنْكَ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثَنَّهُمْ لِنُبْنُوَ بِمَا عَمِلْتُمْ ۚ وَذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴾

"Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë nuk do të ringjallen. Thuaju: Po! Për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjallen, pastaj ju do të njoftoheni për çfarë punuat dhe kjo është mjaft e lehtë për Allahun." [Et Tegabun, 7].

- ❖ **Allahu i Madhëruar i dërgoi të gjithë të dërguarit si përgëzues dhe qortues.**
Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ﴾

"Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut. " [En Nisa, 165].



I pari prej tyre (të dërguarve) është Nuhu عليه السلام dhe i fundi është Muhammedi ﷺ. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّنَ مِنْ بَعْدِهِ﴾

"Ne të kemi shpallur ty sikurse i patëm shpallur Nuhut dhe pejgamberëve pas tij.[En Nisa, 163].

Çdo populli Allahu i Madhëruar i dërgoi të dërguar që prej Nuhut (alejhi selam) e deri tek Muhammedi ﷺ, duke i urdhëruar që të adhuronin vetëm Allahun Një e të vetëm dhe duke i ndaluar ata nga adhurimi i tagutëve (idhujve). Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾

"Ne dërguam në çdo popull të Dërguar që t'u thonë: "Adhurojeni vetëm All-llahun, e largojuni dajave (adhurimit të tyre)!" [En Nahl, 36].

Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë për të gjithë robërit e Tij që ta mohojnë tagutin dhe t'i besojnë Atij. Ibën el Kajjim (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "**Taguti është çdo gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë, duke e pasuar apo duke iu bindur.**"

Tagutët janë shumë e më kryesorët janë pesë:

1. Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!
2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurimi.
3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.
4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
5. Kush gjykon me tjetër gjë pos asaj që ka zbritur Allahu.

Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ قَدْ بَيَّنَّ الرُّشْدَ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدْ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ﴾

"Nuk ka detyrim në fe. Vërtet, Rruga e drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon tagutin dhe beson në Allahun, atëherë ai është kapur për mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë." [El Bekare, 256].

Ky pra, është edhe kuptimi i fjalës "**La ilahe il lAllah**"


Argument nga hadithi:

« رَأْسُ الْأَمْرِ الْإِسْلَامُ، وَعَمُودُهُ الصَّلَاةُ، وَذُرْوَةُ سَنَامِهِ الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ »

"Kreu i çdo çështjeje është Islami, shtylla e tij është namazi ndërsa kulmi i tij është xhihadi në rrugën e Allahut."

Allahu e di më së miri!

Ue sala Allahu ala Muhammedin ue alihi ue sahbihi ue sel lem!




Pyetjet

	Argument nga Kur'ani dhe Sunneti.
Dija, para fjalës dhe punës.	
Vdekja e profetit ﷺ.	
Mesazhi i Tij.	
Katër çështjet.	
Kush përgënjeshtrojnë ringjalljen është jobesimtar.	
Feja e profetëve është unike.	
Hixhreti-migrimi prej vendeve të kufrit (jobesimtarëve).	
Feja Islame është e plotësuar.	
<i>Regbeh</i> -dëshira, <i>rehbeh</i> - frikë-respekti, <i>khushu</i> -nënshtrimi.	
T'i dedikosh ndonjë lloj adhurimi dikujt tjetër veç Allahut është shirk.	
Krijuesi e meriton adhurimin.	
Frika (<i>khauf</i>).	
Shpresa (<i>rexha</i>).	
Druajtja (<i>khashjeh</i>).	
Mbështetja (<i>teuekul</i>).	
Bërja kurban (<i>dhebh</i>).	
Zotimi (<i>nedhr</i>).	
Ringjallja mbas vdekjes.	
Profeti i parë.	
Vula e profetëve.	




Shkruaj çfarë din rreth asaj që vijon:

E mësojmë teuhidin për disa arsye, prej tyre:	1.	2.
	3.	4.
	5.	6.
I mësojmë tri parimet për disa arsye, prej tyre:	1.	2.
	3.	4.
Frytet që rrjedhin prej mësimit të tyre.		
Tri parimet, shkurtimisht.		
Katër çështjet.		
<i>Sikur Allahu i Madhëruar të mos zbriste....</i>		
Llojet e durimit:		
Tre çështjet:	1.	
	2.	
	3.	
Distancimi prej shirkut bëhet me:		
El Hanifijeh.		
Çdo fjalë Jea'budun (adhuroj) në Kur'an e ka kuptimin...		
Teuhidi në aspektin gjuhësor.		
Teuhidi në legjislacionin fetar.		
Teuhidi rububije.		
Teuhidi uluhije.		
Teuhidi esma ue sifet.		






Llojet e du'as (lutjes).	
Llojet e <i>Du'a</i> së lutjes/kërkimit (mes'ele).	
Besimet e njerëzve në lidhje me shkaqet.	
Kushtet për të kërkuar ndihmë nga krijesat.	
Mbështetja (<i>teuekul</i>).	
Druajtja (<i>khashjeh</i>).	
Llojet e zotimit (<i>nedhr</i>).	
Llojet e kurbanit (<i>dhebh</i>).	
Llojet e frikës.	
Kushtet e pranimit të adhurimit.	
Definicioni i Islamit.	
La ilahe il-lAllah (<i>Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut</i>).	
Muhammedi është rob dhe i dërguari i Allahut.	
Gjykimi për bashkimin e feve.	
Besimi në aspektin gjuhësor.	
Besimi në legjislacionin fetar.	
Besimi në Allahun.	
Argumentet që tregojnë ekzistencën e Allahut.	
Besimi në engjëjt e Tij.	
Besimi në librat e Tij.	
Besimi në të dërguarit e Tij.	





Besimi në ditën e fundit.	
Kategoritë e besimit në kader.	
Llojet e xihadit.	
Kategoritë e Ihsanit.	
Robëresha do të lindë zonjën e saj.	
Prejardhja e profetit ﷺ.	
فَمُفَانِذِرْ وَرَبِّكَ فَكَبِّرْ <i>“Ngrihu dhe këshillo!</i> <i>Dhe madhëroje Zotin tënd!”</i>	
وَتِيَابَكَ فَطَهِّرْ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ <i>Dhe rrobat e tua i pastro.</i> <i>Dhe larg nga idhujt qëndro!</i>	
Hixhreti (shpërngulja).	
Koha kur ndërpritet pendimi.	
Për kë u dërgua profeti ﷺ.	
Et Tagut.	
Prijësit e tagutit.	





Shejkh Hejthem Serhan

Shpjegimi i:

Katër Rregullave


شرح قواعد الأربع






Njohja e katër rregullave të cilat i ka përmendur Allahu në librin e Tij.

Katër rregullat: Është përmbledhje e librit Keshfu Shubuhat (Largim i dyshimeve), atëherë përse të mos mësojmë së pari librin Keshfu shubuhat ?					
Kush janë Euliatë e Allahut (të dashurit e Allahut) ? Përgjigjet shejkhul Islam Ibn Tejmijje (Allahu e mëshiroftë) duke thënë: <i>Kush është besimtar dhe është i devotshëm, ai është i dashuri i Allahut.</i>					
Shenjat e lumturisë	Falenderues kur i jepet diçka	Mirësia është sprovë وَتَبْلُوكُم بِالسَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً "Ne do t'ju sprovonimë ju me të keqen dhe me të mirën"	Falënderimi i mirësisë. (Shukru nie'metu)	Falënderimi që ka të bëj me teuhidin rububije	Xhenneti nuk kërkohet veçse prej Allahut, poashtu dhe furnizimi, lidhja duhet të jetë vetëm me Krijuesin, jo me krijesat.
	I durueshëm kur sprovohet	Kategoritë e njerëzve përballë fatkeqësive.		Falënderimi që ka të bëj me teuhidin uluhije	Me zemër: Njohja dhe miratimi i kësaj mirësie.
					Me fjalë: وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ "E me të mirat që t'i dha zoti yt, trego/fol"
					Me gjymtyrë: T'i përdorësh për të falënderuar Allahun, shpenzimi i pasurisë në rrugë të Allahut dhe në bindje ndaj Tij, ndërsa dija u duhet mësuar atyre që e kërkojnë atë.
	Kërkon falje kur mëkaton				
Përse e mësojmë Teuhidin	El hanifije është feja e Ibrahimit, Allahu na ka krijuar që ta adhurojmë Atë, Adhurimi nuk konsiderohet si i tillë veçse me Teuhid, nëse shirku hyn në adhurim e prish atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që bën shirk hyn përjetësisht në Zjarrin e Xhehenemit.				







Katër rregullat	<u>Rregulli i parë:</u> Të dish se mosbesimtarët në kohën e profetit ﷺ e pranonin teuhidin rububije (se Allahu është Krijuesi, Sistemuesi i të gjitha çështjeve), porse nuk pranonin teuhidin uluhije (ta adhuronin Allahun të vetëm) dhe për këtë i luftoi profeti ﷺ.
	<u>Rregulli i dytë:</u> Mosbesimtarët në kohën e profetit, të cilët u luftuan nga Ai, nuk i adhuronin idhujt duke besuar se ato të bëjnë dobi apo të shkaktojnë dëm, porse i adhuronin si ndërmjetësim apo afrim tek Allahu.
	<u>Rregulli i tretë:</u> Pejgamberi ﷺ takoi njerëz që ndryshonin në adhurimet e tyre. I Dërguari i Allahut ﷺ i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.
	<u>Rregulli i katërt:</u> Idhujtarët e kohës sonë janë më të këqij në shirkun e tyre se idhujtarët e mëparshëm (që kanë qenë në kohën e profetit).



Hjet e ndërmjetësimit (shefa'a)





Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab

Katër rregullat



القواعد الأربع

Katër rregullat

Shejhul Islam Muhamed bin Abdul-Uehab



Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!

Lus Allahun, më Bujarin, Zotin e Fronit, që t'ju mbrojë në këtë botë dhe në Jetën e Përtejme, dhe t'ju bekojë kudo që jeni dhe t'ju bëjë prej atyre që janë falënderues kur u jepet, të durueshëm kur sprovohen dhe ata që kërkojnë falje kur mëkatojnë, se vërtet, këto janë tri shenjat e lumturisë.

Dije, Allahu të udhëzoftë që t'i bindesh Atij, se *Hanefije* është feja e Ibrahimit: Kjo është që ta adhuron Allahun duke e praktikuar fenë vetëm për Të, siç tha Ai:

﴿ وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ﴾

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë Mua.[Edh Dharijat, 56].

Kur ju të pranoni se Allahu ju ka krijuar për adhurimin e Tij, atëherë ta dini se adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, ashtu siç namazi nuk konsiderohet namaz, përveçse nëse është i shoqëruar me pastrim (*tahara*). Kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e çoroditë atë ashtu si papastërtia e zhvlerëson pastërtinë.

Pra kur ta dini se nëse shirku hyn në adhurimin tuaj ai e çorodit atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që e bën atë përgjithmonë është në Xhehenem, atëherë ju do ta kuptoni çështjen e detyrueshme dhe më të rëndësishmen për ju: njohjen e këtij fakti, me qëllim që Allahu t'ju shpëtojë nga skëterra e të bërit shirk ndaj Tij, për të cilën Ai, më i Lartësuari, tha,

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ﴾

“Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohen Atij ortakë në adhurim, por Ai i fal përveç kësaj (çfarëdo tjetër) kujtdo qoftë që Ai dëshiron.” [en-Nisa 4:116]

Kjo dituri përfshin katër parimet të cilat Allahu, më i Lartësuari, i ka përmendur në Librin e Tij.



- ✽ **Rregulli i parë** është që ta dish se jobesimtarët, të cilët i Dërguari ﷺ i luftoi, e pranonin se Allahu, më i Lartësuari, ishte Krijuesi dhe Rregulluesi i të gjitha çështjeve, por kjo nuk i futi në Islam dhe dëshmi për këtë është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

﴿ قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمَّنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدِيرُ الْأَمْرَ ۚ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا نُنْقِزُ ۚ ﴾ (٢١)

“Thuaj: Kush ju furnizon nga qielli dhe nga toka? Apo kush posedon të dëgjuarit dhe të parit? Dhe kush e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe e nxjerr të vdekurin prej të gjallit? Ata do të thonë: “Allahu.” Thuaj: “A s’do të frikësoheni atëherë nga dënimi i Allahut (për atë se i përshkruani rival në adhurim Allahut)?” [Junus 10:31]

- ✽ **Rregulli i dytë:** Se ata (idhujtarët) thonë: “Ne nuk u lutemi dhe nuk u drejtohem idhujve përveçse që të kërkojmë afërsi dhe ndërmjetësim (me Allahun)”. Pra, dëshmia kundër kërimit të afërsisë (përmes *eulijave*) është thënia e Tij,

﴿ وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَاذِبٌ كَفَّارٌ ۚ ﴾ (٣)

“Dhe ata që marrin *eulija* (mbrojtës) krahas Tij (thonë): “Ne i adhurojmë ata vetëm që të na ofrojnë tek Allahu.” Vërtet, Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çka ata s’pajtoheshin. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe jobesimtar.”

[ez-Zumer 39:3]

Dëshmia kundër ndërmjetësimit (përmes *evliave*) është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

﴿ وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شَفَعَتُونَا عِنْدَ اللَّهِ ۚ ﴾

“Dhe ata adhurojnë përveç Allahut gjëra të cilat nuk u sjellin as dëm as dobi, dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.” [Junus 10:18]

❖ **Ndërmjetësimi është dy llojesh:**

1. Ndërmjetësimi i ndaluar dhe
2. ndërmjetësimi i lejuar.

Ndërmjetësimi i ndaluar është ai që kërkohet prej tjetër pos Allahut dhe ka të bëjë me atë çka vetëm Allahu ka mundësi të bëjë. Dëshmi për këtë është thënia e Tij :

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَنْفِقُوا مِمَّا رَزَقْنَاكُمْ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَ يَوْمٌ لَا بَيْعٌ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا شَفْعَةٌ ۚ﴾

﴿وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ﴾

“O ju që besoni! Shpenzoni prej asaj që Ne ju kemi dhënë, para se të vijë një Ditë kur nuk do të ketë pazarllëk, shoqëri apo ndërmjetësim. Dhe jobesimtarët janë Dhalimun (keqbërës, etj.).”
[el-Bekare 2:254]

Ndërmjetësimi i lejuar është ai i cili kërkohet prej Allahut derisa ndërmjetësuesi është i nderuar me ndërmjetësim, dhe ai për të cilin ndërmjetësohet është dikush veprat dhe fjalët e të cilit janë të kënaqshme për Allahun, pasi që Ai ta lejojë këtë, ashtu siç tha Ai, më i Lartësuar :

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ﴾ البقرة: ٢٥٥


“Kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveç me lejen e Tij?” [el-Bekare 2:255]

❖ **Rregulli i tretë** është ai se Pejgamberi (salAllahu alejhi ue selam) takoi njerëz që dallonin në adhurimin e tyre. Në mesin e tyre qenë njerëzit që adhuronin engjëj, disa që adhuronin pejgamberë dhe njerëz të drejtë, si dhe të tjerë të cilët adhuronin gurë, drurë, diellin dhe hënën. I Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selam) i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.

Dëshmi është thënia e Allahut, më të Lartësuarit,

﴿وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ الدِّينُ كُلُّهُ لِلَّهِ ۚ﴾

“Dhe luftoni ata derisa të mos ketë më fitne (mosbesim dhe adhurim të të tjerëve së bashku me Allahun) dhe tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun.” [el-Bekare 2:193]



- ❖ Dhe dëshmi se dielli dhe hëna (adhurohen) është thënia e më të Lartësuarit,

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ وَاسْجُدُوا لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ﴾ (37)

“Dhe prej Shenjave të Tija janë nata dhe dita, si dhe dielli dhe hëna. Mos i bëni sexhde diellit dhe hënës.” [Fusilet 41:37]

- ❖ Dhe dëshmi për atë se engjëjt adhurohen është thënia e më të Lartësuarit,

﴿وَلَا يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَتَّخِذُوا الْمَلَائِكَةَ وَالنَّبِيِّينَ أَرْبَابًا﴾

“E, as që do t’ju urdhëronte ai (pejgamberi) që t’i merrni engjëjt dhe pejgamberët për zota”

[Ali-‘Imran 3:80]

- ❖ Dëshmi se pejgamberët adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:


﴿وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يٰعِيسَىٰ ابْنَ مَرْيَمَ ءَأَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمِّي آلِهَتَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ قُلْ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقٍّ إِن كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ تَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ﴾ (116)

“Dhe kur Allahu të thotë (në Ditën e Ringjalljes) “O Isa, biri i Merjemes, a u ke thënë ti njerëzve, “Më adhuroni mua dhe nënën time si dy zota krahas Allahut”. Ai do të thotë, “Lavdi të qoftë ty! Nuk më takon mua ta them atë që s’kam të drejtë (ta them). Sikur të kisha thënë një gjë të tillë, Ti me siguri do ta dije atë. Ti e di se çfarë ka në mua ndonëse unë nuk e di se ç’ka në Ty. Vërtet, Ti je i Gjithëdijshtëm për tërë atë që është e fshehur.” [el-Maide 5:116]

- ❖ Dëshmi se njerëzit e drejtë adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:

﴿أُولَٰئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ رَحْمَتَهُ وَيَخَافُونَ عَذَابَهُ﴾

“Ata të cilët i lusin, vetë kërkojnë mënyra për afrim ndaj Zotit të tyre (Allahut), se cili prej tyre do të jetë më i afërti dhe ata e shpresojnë Mëshirën e Tij dhe i frikësohen Torturës së Tij.” [el-Isra 17:57]



❖ Dëshmi se gurët dhe drunjtë adhurohen është thënia e Tij, më të Lartësuarit,

﴿ أَفَرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّىٰ ۖ وَمَنَاةَ الثَّالِثَةَ الْأُخْرَىٰ ۚ ﴾

“ ju i morët në konsiderim el-Lat dhe el-Uza. Dhe Menatin, të tretin tjetër?”

[en-Nexhm 53:19-20]

Dhe hadithin e Ebu Uekid el-Lejthit (radiAllahu anhu) i cili tha: “Ne u nisëm me Pejgamberin (salAllahu alejhi ue selam) për në Hunejn dhe ishim të rinj në Islam. Idhujtarët kishin një dru të cilit i përkushtoheshin dhe në të cilin i varnin armët e tyre, dhe atë dru e quanin ‘Dhat Enuat’. Ne kaluam pranë një druri dhe thamë, “O i Dërguar i Allahut, na cakto edhe neve një Dhat Enuat ashtu siç ata kanë një Dhat Enuat. Ai tha, “Allahu Ekber! Allahu Ekber! Allahu Ekber! Pasha atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, këto janë rrugët. Kjo që thatë është e njëjtë me atë çka i thanë Benu Israilët Musait, “Na e bën edhe neve një zot sikurse zotat e tyre.” Ai tha, “Vërtet ju jeni njerëz injorantë.” [el-A’raf 7:138] [Transmetuar nga et-Tirmidhi (2180) i cili tha se hadithi është Hasan Sahih, dhe Ahmed (5/218), Ibn Ebi Asim në es-Sune (76), Ibn Hibban në Sahinë e tij (6702) dhe qe bërë autentik nga Ibn Haxher në el-Isabe (4/216).]


❖ **Rregulli i katërt** është ai se idhujtarët e kohës sonë janë më të këqinj në shirkun e tyre se idhujtarët që erdhën para tyre. Kjo është kështu sepse ata që erdhën para tyre bënë shirk gjatë kohës së rehatisë dhe e bënë adhurimin e tyre vetëm për Allahun kur gjindeshin në vështirësi. Mirëpo, shirku i idhujtarëve të kohës sonë është i vazhdueshëm, gjatë gjendjes së rehatisë dhe vështirësisë.

Dëshmi është thënia e Tij :

﴿ فَإِذَا رَكِبُوا فِي الْفُلِ دَعَا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ فَلَمَّا نَجَّاهُمْ إِلَى الْبَرِّ إِذَا هُمْ يُشْرِكُونَ ﴾

“Dhe kur ata hipin në anije e lusin Allahun duke e pasur besimin e pastër vetëm për Të, ndërsa kur Ai i sjellë ata të sigurt në tokë, vëni re, ata i japin të tjerëve një pjesë të adhurimit të tyre.” [el-Ankebut 29:65]

Dhe Allahu, i Lartësuari, e di më së miri. Lutjet dhe paqja qofshin mbi Muhammedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.



Pyetjet


Shkruaj çfarë di rreth asaj që vijon:

Përse e mësojmë librin “Katër rregullat” ?	1.	2.
Përse nuk mësojmë librin “Keshfu shubuhât” së pari ?		
Kush janë evliatë e Allahut, me argument.		
Si është Falënderimi i mirësisë (shukru niemeh).	Ka të bëjë me teuhidin	
	Ka të bëjë me teuhidin	
Kategoritë e njerëzve përballë fatkeqësive, përmend dhe gjykimin për secilën kategori.		
Shenjat e lumturisë.		
Shefa’a në aspektin gjuhësor.		
Shefa’a në legjislacionin fetar.		
Kushtet e Shefa’a.		
Rregulli i parë.		
Rregulli i dytë.		
Rregulli i tretë.		
Rregulli i katërt.		



Shkruaj një argument nga Kur'ani ose Sunneti për atë që vijon:


	Argument nga Kur'ani ose Sunneti.
Mirësia është provë.	
Jobesimtarët e pranonin teuhidin rububije.	
Kërkimi i afërsisë.	
Ndërmjetësimi i ndaluar.	
Ndërmjetësimi i lejuar.	
Argumenti për diellin dhe hënën.	
Argumenti për engjëjt.	
Argumenti për profetët.	
Argumenti për njerëzit e mirë.	
Argumenti për gurët dhe drurët.	
Argumenti se idhujtarët janë të sinqertë në adhurim kur janë në veshtirësi dhe bëjnë shirk kur janë në rehati.	





Shkruaj me hollësi llojet e ndërmjetësimit (*Shefa'a*)








Shejkh Abdulaziz bin Abdilah bin Baz

Mësime të rëndësishme

الكاروسل المهمة لعامة الأمة



Përshtati në shqip: Bledar Aliu

Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë

Autor: Muftiu i madh, Shejkh Abdulaziz bin Abdilah bin Baz, Allahu e mëshiroftë!



Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi robin dhe të dërguarin e Tij, Muhamed, mbi familjen dhe mbi të gjithë shokët e tij dhe ata që e ndjekin atë deri në Ditën e Gjykimit.

Këto janë pak fjalë rreth sqarimit të disa çështjeve mbi fenë Islame, të cilat duhet t'i njohë masa e gjerë e popullit. Lus Allahun që ky libërth t'iu bëjë dobi muslimanëve dhe ta pranojë prej meje këtë vepër! Ai me të vërtetë është Bujar me bujari të Pakufishme. Abdulaziz bin Abdilah bin Baz

✿ Mësimi i parë

Mësimi i sures el-Fatiha dhe suret e tjera të shkurtëra nga surja Ez-Zelzeleh (Tronditja e madhe) deri në suren En-Nas (**Njerëzit**), të cilat duhet të shprehen mirë, duke i mësuar përmendësh me lexim të saktë dhe duke njohur kuptimin e tyre me shpjegim e komentim.


✿ Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit

Njohja e pesë shtyllave të Islamit duke filluar me shtyllën e parë e cila është më themelorja e **tyre**. Dëshmia se nuk ka të adhuruar (Zot) tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, duke i mësuar me shpjegim kuptimet e tyre duke filluar me kushtet e fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH (*Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut*) që shpjegohet:

- **LA ILAHE:** Mohon gjithçka që adhurohet përveç Allahut.
- **IL-LA ALLAH:** Dedikon dhe thekson të gjitha llojet e adhurimit për Allahun një të vetëm dhe pa i shoqëruar asnjë ortak.

❖ Kushtet e fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH:

1. Dituria e cila mohon injorancën.
2. Siguria e plotë e cila mohon gënjeshtren.
3. Singeriteti i cili mohon shirkun.
4. Thënia e së vërtetës e cila përjashton gënjeshtren.
5. Dashuria e cila mohon urrejtjen.
6. Zbatimi i të gjitha shtyllave duke përjashtuar lënien e diçkaje prej tyre.
7. Pranimi i cili mohon refuzimin dhe mohimi i gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut.



- ❖ Gjithashtu, duhet mësuar **dëshmia**: "**Muhammedun resulullah**, (Muhammedi është i dërguari i Allahut)" që nënkupton:
1. T'i besosh atij për çdo gjë që ka njoftuar.
 2. T'i bindesh për çdo gjë që ka urdhëruar.
 3. T'i largohesh çdo gjëje që e ka ndaluar dhe e ka penguar.
 4. Të mos adhurohet Allahu me mënyrë tjetër përveç se me atë mënyrë që ka ligjëruar Allahu dhe i dërguari i Tij.

Më pas i sqarohen nxënësit të dijes pesë shtyllat e tjera të Islamit të cilat janë: namazi, zekati, agjërimi i Ramazanit dhe haxhi (vizita e shtëpisë së shenjtë të Allahut), për atë që ka mundësi.

❖ **Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit)**

Shtyllat e imanit janë gjashtë:

1. Të besosh Allahun.
2. Engjëjt e Tij.
3. Librat e Tij.
4. Të dërguarit e Tij.
5. Ditën e fundit.
6. Besimi në kaderin (caktimin) e Allahut të Madhëruar për të mirë apo për të keq.


❖ **Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe shirkut**

Teuhidi ndahet në tre lloje:

- ☞ Teuhidi rububijeh,
- ☞ Teuhidi uluhijeh,
- ☞ Teuhidi esmau ues sifati

1. Teuhidi rububijeh, është të besuarit se Allahu është Krijuesi i gjithçkaje, Poseduesi dhe sunduesi i çdo gjëje dhe nuk e shoqëron Atë askush në këtë.

2. Teuhidi uluhijeh (i adhurimit), është të besuarit se Allahu i Madhëruar është i vetmi që e meriton adhurimin dhe nuk ka asnjë ortak në të. Ky është dhe kuptimi i fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH. Kuptimi i saj është: *nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut*. Pra, të gjitha llojet e adhurimit si: namazi, agjërimi, haxhi, etj, duhet të kryhen vetëm për Allahun, dhe nuk lejohet kryerja e diçkaje prej tyre për dikë tjetër veç Allahut.



3. Teuhidi esmau ues sifat (i emrave dhe i cilësive), është besimi në çdo gjë që ka transmetuar tek ne Kur'ani famëlartë ose në hadithet e sakta të profetit, prej emrave të Allahut dhe cilësive të Tij, në mënyrën që i përshtatet Allahut të Madhëruar pa i deformuar, pa i ndryshuar, pa pyetur për mënyrën se si janë dhe pa i krahasuar ato me ndonjë prej krijesave, siç thotë Allahu:

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ (١) اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ (٢) لَمْ يَكِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ (٣) وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ﴾

"Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. Nuk ka lindur kënd dhe nuk është i lindur. Dhe nuk ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me të." [Sure Ihlas: 1-4]

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ۝ (١١)﴾

"Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi." [Sure Esh-Shura: 11]

Disa dijetarë e ndajnë teuhidin në dy lloje, duke futur teuhidin Esmau ues Sifat në teuhidin Rububijeh. Nuk ka asnjë mospërputhje në këtë ndarje sepse qëllimi është i qartë në të dyja ndarjet.

❖ Llojet e shirkut.

Shirku ndahet në tre lloje:

1. Shirku i madh, i cili detyron asgjësimin e punës dhe përjetshmërinë në zjarr për atë që vdes në këtë gjendje, pra, duke bërë shirk të madh. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحِطَ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝ (٨٨)﴾


"Por sikur ata të kishin bashkuar të tjerë në adhurimin e Allahut (t'i kishin vënë shok Allahut në adhurim), gjithçka që ata kanë punuar do të kishte qenë pa asnjë vlerë për ta. [Sure En-A'am: 88]

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ بِالْكُفْرِ أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ

أَعْمَالُهُمْ فِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ ۝ (١٧)﴾ التوبة: ١٧

"Nuk është e drejtë e idhujtarëve të kujdesen për xhamitë e Allahut, duke qenë se vetë dëshmojnë për vetet e tyre se janë mohues. Të tillëve u shkuan kot veprat e tyre, dhe ata janë përgjithmonë në zjarr." [Sure Et-Teube: 7]



Kush vdes duke praktikuar këtë shirk i nuk falet asnjëherë, dhe xhenneti është i ndaluar për të, siç thotë Allahu i Lartëmadhëruar:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ﴾

"Nuk ka dyshim se Allahu nuk fal (gjynahun) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përveç këtij (gjynahi), i fal kujt do." [Sure En-Nisa: 48]

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾

"...ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhenetin dhe vend i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës." [Sure El- Maideh: 72]

Prej llojeve të këtij shirku janë: lutja e të vdekurve dhe e idhujve, kërkimi i ndihmës prej tyre, tavafi rreth varreve, premtimi i diçkaje për ta, kurhani për ta etj...

2. Shirku vogël është çdo gjë që është cilësuar shirk në tekstin e Kur'anit dhe sunetit, por që nuk arrin deri në gradën e shirkut të madh si p.sh: syfaqësia në vepra, betimi në diçka tjetër veç Allahut, thënia: çfarë dëshiron Allahu dhe filani, etj... Pejgamberi thotë: Gjëja që i frikësohem më shumë për ju është shirku i vogël. E pyetën rreth tij dhe ai u përgjigj duke thënë: Ai është syfaqësia. [Trans. Imam Ahmedi, Taberani dhe Bejhekiu nga Muhamed bin Lebid El-Ensarij- Allahu qoftë i kënaqur prej tij - me zinxhir transmetimi të mirë prej Muhamed bin Lebid, prej Rafi' bin Khadijxh, nga profeti.

Pejgamberi ﷺ thotë:

« مَنْ حَلَفَ بِشَيْءٍ دُونَ اللَّهِ فَقَدْ أَشْرَكَ »

"Kush betohet me diçka përveç Allahut ka bërë shirk."

[Trans. Imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të saktë nga Umer bi Khatab- Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

Gjithashtu e transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu me zinxhir transmetimi të saktë prej hadithit të ibn Umerit- Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve - se profeti ﷺ thotë:

« مَنْ حَلَفَ بِغَيْرِ اللَّهِ فَقَدْ كَفَرَ أَوْ أَشْرَكَ »

"Kush betohet në diçka tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër (mohim) ose shirk."

Pejgamberi ﷺ thotë:

« لَا تَقُولُوا مَا شَاءَ اللَّهُ وَشَاءَ فُلَانٌ وَلَكِنْ قُولُوا مَا شَاءَ اللَّهُ ثُمَّ شَاءَ فُلَانٌ »

"Mos thoni çfarë dëshiroi Allahu dhe dëshiroi filani, por thoni: Çfarë dëshiroi Allahu dhe pastaj dëshiroi filani."

[Trans. Ebu Daudi me zinxhir transmetimi të saktë nga Hudhejfe ibn Jemani- Allahu qoftë i kënaqur prej tij.]

Ky lloj i shirkut nuk detyron nxjerrjen nga feja dhe nuk detyron përjetshmërinë në zjarr, por mohon përsosmërinë e teuhidit që është detyrë.

3. Shirku i fshehtë. Argument për këtë është fjala e profetit ﷺ:

« أَلَا أُخْبِرُكُمْ بِمَا هُوَ أَخْوَفُ عَلَيْكُمْ عِنْدِي مِنَ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ؟ » قَالُوا: (بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ).
 قَالَ: « الشِّرْكُ الْخَفِيُّ، يَقُومُ الرَّجُلُ فَيُصَلِّيُ فَيَزِينُ صَلَاتَهُ لِمَا يَرَى مِنْ نَظَرِ رَجُلٍ »

"A t'ju njoftoj për diçka që e kam frikë për ju më shumë se mesihi Dexhall? Thanë: -Po, o i dërguar i Allahut! Tha: Shirku i fshehtë, kur ndonjëri çohet dhe falet dhe fillon ta zbukurojë namazin e tij, kur e ndjen se shikimet e njerëzve po e ndjekin."


[Trans. Imam Ahmedi ne veprën e tij "El-musned" prej hadithit të Ebu Seid El-Khudrij – Allahu qoftë i kënaqur prej tij.]

Gjithashtu lejohet që të ndahet shirku në dy kategoritë e mëposhtme:

Shirku i madh dhe shirku i vogël, kurse për sa i përket shirkut të fshehtë ai përfshihet tek të dyja. Shirku i fshehtë përfshihet në shirkun e madh si p.sh shirku i munafikëve (hipokritëve), kur ata fshehin besimet e tyre të kota dhe shfaqin Islamin sa për sy e faqe ose nga frika se mos dëmtohen.

Gjithashtu shirku i fshehtë përfshihet në shirkun e vogël në rastin e **syefaqësisë**, siç e përmendëm në hadithin e Muhamed bin Lebid El-Ensarij dhe në hadithin e Ebu Seidit, që u përmendën më parë dhe do i përsërisim:

"Gjëja që i frikësohem më shumë për ju është shirku i vogël. E pyetën rreth tij dhe u përgjigj duke thënë: Ai është syfaqësia. "A t'ju njoftoj për diçka që e kam frikë për ju më shumë se mesihi Dexhall? Thanë: -Po, o i dërguar i Allahut! Tha: Shirku i fshehtë, kur ndonjëri çohet dhe falet dhe fillon ta zbukurojë namazin e tij, kur e ndjen se shikimet e njerëzve po e ndjekin."



✿ Mësimi i pestë: Ihsani (Bamirësia)

Ihsani është të adhurosh Allahun sikur ta shikosh atë, sepse edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty.

✿ Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit


Kushtet e namazit janë nëntë:

1. Islami.
2. Logjika.
3. Mosha e pjekurisë.
4. Pastrimi nga papastërtitë si nevoja, marrdhëniet etj.
5. Largimi i pislëkut konkret si urina apo e vjella.
6. Mbulimi i pjesës së turpshme.
7. Hyrja e kohës.
8. Drejtimi nga kibla.
9. Nijeti (qëllimi).

✿ Mësimi i shtatë: Ruknet (shtyllat) e namazit

Shtyllat e namazit janë 14:

1. Qëndrimi në kijam (këmbë) për atë që ka mundësi.
2. Tekbiri fillestar.
3. Leximi i Fatihasë.
4. Rukuja.
5. Të drejtuarit e trupit mbas rukusë.
6. Të rënit në sexhde me shtatë pjesët e trupit.
7. Ngritja prej sexhdes.
8. Qëndrimi midis dy sexhdeve.
9. Qetësimi (prehja) në të gjitha veprimet.
10. Renditja ndërmjet shtyllave.
11. Teshehudi i fundit.
12. Ulja (qëndrimi) për leximin e teshehudit të fundit.
13. Salauatet për Profetin
14. Dhënia e selamit.



✿ Mësimi i tetë: Detyrat e namazit

Detyrat e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret, përveç tekbirit fillestar.
2. Thënia *"SemiAllahu limen hamideh.* (Pa dyshim) Allahu e dëgjon njeriun që e falenderon Atë," për Imamin dhe për atë që falet vetëm.
3. Thënia *"Rabbena ue lekel hamd.* Zoti ynë! Ty të takon Falënderimi," për të gjithë.
4. Thënia *"Subhane rabbijeladhim!* Larg të metave është Zoti im i madhëruar," në ruku.
5. Thënia *"Subbhane Rabbijel a'la!* I Lartësuar është Zoti im i Lartësuar." në sexhde.
6. Thënia *"Rabbigfirli!* O Zot, më fal." midis dy sexhdeve.
7. Teshehudi i parë.
8. Ulja (qëndrimi) për leximin e tij.

✿ Mësimi i nëntë: Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti

Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti është:

« التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ. »

Et-tahijjatu lil-lahi ues-salauatu uet-tajjibatu, ues-selamu alejke ejjuhen-nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu. Es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin. Eshhedu en la ilahe il-lAllahu ue eshedu enne Muhameden abduhu ue resuluhu.


(Lavdërimet më të mira janë vetëm për Allahun. Urimet më të mira qofshin mbi ty, o pejgamber (i Allahut), mëshira dhe lavdërimet e Allahut qofshin gjithmonë mbi ty! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robtë e mirë e të çiltër."

Më pas të bëjë salauat mbi pejamberin duke thënë:

« اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ. »

Allahume sal-li ala Muhammedin ue ala eli Muhammed, kema sal-lejte ala Ibrahime ue ala eli Ibrahim. Inneke Hamidun Mexhid.

Allahume barik ala Muhammedin ue ala eli Muhammed, kema barekte ala Ibrahime ue ala eli Ibrahim. Inneke Hamidun Mexhid."





(O Allah, mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij. O Allah, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij.)

Më pas në teshehudin e fundit kërkon mbrojtje nga Allahu prej dënimit të zjarrit, të varrit, prej sprovimit të jetës e të vdekjes dhe prej sprovimit të mesihu Dexhallit. E më pas të zgjedhë prej lutjeve çfarë të dojë, veçanërisht ato lutje që janë transmetuar në sunet, si p.sh:

«اللَّهُمَّ اَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ»

- Allahume e'inni ala dhikrike ue shukrike ue husni ibadetike.


(O Allah, më ndihmo që të të kujtoj Ty (sa më shumë), të të falenderoj (vetëm) Ty, e që të të adhuroj ashtu siç duhet.)

«اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ فَاعْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ»

- Allahume inni dhalemtu nefsij dhulmen kethira, ue la jegfiru dhunube il-la ente, fegfirli magfireten min indike, uerhamni, inneke entel Gafurru Rrahim.


(O Allah! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes dhe askush nuk i fal gjuhahet përveç Teje. Më fal mua me faljen tënde dhe më mëshiro, me të vërtetë që Ti je Falës dhe Mëshirplotë.)

Në teshehudin e parë çohet pas dy dëshmime në rekatin e tretë në namazet e drekës, ikindisë, akshamit dhe jacisë, por nëse lexon edhe salauatet mbi peygamberin kjo është më mirë, për arsye se hadithet kanë ardhur në përgjithësi, e më pas të çohet në rekatin e tretë.



❁ Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit

1. Duaja e hapjes (*SubhanekeAllahume ue bihamdike...*).
2. Vendosja e dorës së djathtë mbi të majtën në gjoks kur je në këmbë (kijam) para rukusë dhe pas saj.
3. Ngritja e dy duarve me gishtërinj të hapur deri te supet ose deri tek veshët në tekbinin e parë, në shkuarjen në ruku, në ngritjen prej rukusë dhe në ngritjen prej teshehudit të parë për në rekatin e tretë. \
4. Të lexuarit (të thënit) më shumë se një herë në tesbihun e rukusë dhe sexhdes, "*Subhane Rabbijeladhim*" dhe "*Subhane Rabbijel Ala*".
5. Të lexuarit më shumë se thënia "*Rabbena ue lekel Hamd*" mbas ngritjes prej rukuje qoftë për imamin, xhematin, apo për atë që falet vetëm dhe të shtuarit më shumë se njëherë në duanë për falje "*Rabbij gfirmij*" midis dy sexhdeve.
6. Drejtimi i kokës me shpinën (të qëndruarit me një drejtim) në Ruku.
7. Largimi i dy krahëve në dy anët, largimi i barkut prej kofshëve dhe largimi i kofshëve me dy kërcinj të këmbës në sexhde.
8. Ngritja e dy bërrylave (parakrahëve) nga toka në sexhde.
9. Ulja e falësit mbi këmbën e majtë të tij të shtrirë dhe ngritja e të djathtës në teshehudin e parë dhe midis dy sexhdeve.
10. Eteuerruku (futja e këmbës së majtë poshtë të djathtës në uljen në tokë dhe duke ngulitur gishtërinjtë e këmbës së djathtë) në teshehudin e fundit, në namazin me tre ose katër rekate.
11. Drejtimi i gishtit tregues nga kibla në teshehudin e parë dhe të dytë prej kohës që ulet derisa mbaron teshehudin dhe levizja e tij tek duatë.
12. Leximi i salavatit dhe berekatit mbi Muhammedin dhe mbi familjen e tij, gjithashtu mbi Ibrahimin dhe familjen e tij në teshehudin e parë.
13. Duaja në teshehudin e fundit.
14. Leximi me zë në namazin e Sabahut, Xhumasë, dy Bajrameve, namazin e Shiut dhe në dy rekatet e para në namazin e akshamit dhe jacisë.
15. Leximi pa zë në namazin e Drekesë, Ikindisë, në rekatin e tretë të Akshamit dhe në dy rekatet e fundit të Jacisë.
16. Leximi i Kur'anit pas Fatihës.
17. Vendosja e dy duarve mbi gjunjët me gishta të hapur në ruku.
18. Të treguarit kujdes për të gjitha ato që transmetohen prej syneteve në namaz.



✿ Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që prishin namazin

1. Çdo fjalë që thuhet qëllimisht duke qenë i vëmendshëm dhe duke e ditur që kjo gjë e prish namazin, kurse për sa i përket të paditurit e atij që harron kjo gjë nuk ia prish namazin.
2. Qeshja.
3. Ngrënia.
4. Pirja.
5. Zbulimi i aures (pjesës së turpshme).
6. Mënjanimi i tepërt nga drejtimi i kiblës.
7. Rrëmuja e tepërt dhe e vazhdueshme në namaz.
8. Prishja e abdesit.

✿ Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit


Kushtet e abdesit janë dhjetë:

1. Islami.
2. Logjika.
3. Mosha e pjekurisë.
4. Nijeti (qëllimi).
5. Të këtë si qëllim mosndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet pastërtia e tij.
6. Ndërprerja që detyron abdesin.
7. Pastrimi me ujë ose gurë para abdesit, pasi ke kryer nevojën.
8. Pastërtia e ujit dhe qenia e tij në gjendje të lejueshme.
9. Heqja e çdo gjëje që pengon qarkullimin e ujit në vendet që duhen larë gjatë abdesit.
10. Hyrja e kohës së namazit për sa i përket atij që ka papastërti të përhershme.

✿ Mësimi i trembëdhjetë: Obligimet e abdesit

1. Obligimet e abdesit janë gjashtë:
2. Larja e fytyrës, e prej saj është larja e gojës dhe shfryrja e hundëve.
3. Larja e duarve deri në bërryla.
4. Mes'hi (fërkimi i të gjithë kokës me duar të lagura), e prej kokës janë edhe veshët.
5. Larja e këmbëve së bashku me kyçet e këmbëve.
6. Ruajtja e rradhës së abdesit.
7. Mosndërprerja e larjes së pjesëve që përmendëm duke u tharë njëra pjesë, pastaj të lash tjetrën.

E pëlqyeshme është përsëritja e larjes së fytyrës, duarve, këmbëve, shpërlarja e gojës dhe shfryrja e hundës nga tri herë. Po, siç e përmendëm dhe më lart, obligim është vetëm një herë. Kurse për sa i përket mes'hit të kokës nuk është e pëlqyeshme përsëritja e tij, siç kanë argumentuar hadithet e sakta.



✿ Mësimi i katërbëdhjetë: Gjëra që e bëjnë të pavlefshëm abdesin.


Ato janë gjashtë:

1. Çdo gjë që del nga dy vendet e jashtëqitjes.
2. Dalja e diçkaje të ndyrë dhe të pistë prej trupit.
3. Largimi i vetëdijes me anë të gjumit apo të diçkaje tjetër.
4. Prekja e organit me dorë duke mos pasur asnjë pengesë, qoftë organi para ose mbrapa.
5. Ngrënia e mishit të devesë.
6. Largimi nga Islami, Allahu na mbroftë ne dhe të gjithë muslimanët nga kjo.

Shënim i rëndësishëm: Për sa i përket larjes së të vdekurit, mendimi më i saktë është se nuk e bën të pavlefshëm abdesin. Kjo është thënia e shumicës së dijetarëve, sepse nuk ka argument për këtë. Por, ai që e lan të vdekurin, nëse e prek me dorë organin e të vdekurit duke mos patur asnjë pengesë, e ka të detyrueshëm abdesin. Ai e ka detyrë të mos e prek organin e të vdekurit pa një pengesë, si rrobë etj. Gjithashtu duhet ditur se prekja e gruas nuk e bën të pavlefshëm abdesin asnjëherë, qoftë prekja me epsh apo pa epsh. Në këtë çështje ekzistojnë dy mendime, por mendimi më i saktë është që nuk e bën të pavlefshëm abdesin përderisa nuk del diçka prej tij, sepse pejgamberi i puthte gratë e tij, pastaj falej duke mos marrë abdes. Kurse fjala e Allahut "...ose kontaktuat me gratë", ka për qëllim marrëdhëniet seksuale. Pra, në këtë çështje ka dy mendime, por mendimi më i saktë është ky që përmendëm. Gjithashtu ky është mendimi i Ibn Abbasit – Allahu qoftë i kënaqur prej tij - dhe mendimi i shumë dijetarëve prej gjeneratave të para dhe të mëvonshme.

✿ Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralin që na ka urdhëruar sheriatin e me të cilin duhet të stoliset çdo musliman si:

1. Thënia e së vërtetës (sinqeriteti).
2. Përmbushja e amanetit.
3. Ruajtja e nderit.
4. Turpi.
5. Trimëria.
6. Bujaria.
7. Mbajtja e besës.
8. Largimi nga çdo gjë që na ka ndaluar Allahu.
9. Respektimi i fqinjit.
10. Ndhurma ndaj të vobektëve sipas mundësisë.
11. Gjithashtu duhet të karakterizohemi me moralet e tjera të cilat kanë ardhur në Kur'an dhe Sunet.



❁ Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi me edukatë Islame si:

1. Përshëndetja Islame.
2. Dashamirësia.
3. Ngrënia me dorën e djathtë.
4. Pirja me dorën e djathtë.
5. Thënia "*Bismilah*" në fillim të çdo pune.
6. Thënia "*El-hamdulilah*" në mbarim të çdo pune.
7. Thënia "*El-hamdulilah*" kur teshtin.
8. Thënia "*Jerhamuka Allah*" (Allahu të mëshiroftë), kur dikush teshtin dhe falënderon Allahun, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes për namaz dhe varrim.
9. Edukatat e ligjëruara nga ligji Islam në Kur'an dhe Sunet gjatë hyrjes dhe daljes në xhami dhe shtëpi, në udhëtim, edukata me prindërit, të afërmit dhe fqinjët, me të moshuarit dhe me të vegjëlit.
10. Urimi për të porsalindurin dhe urimi për bereqet për të porsamartuarit.
11. Ngushëllimi në fatkeqësi.
12. Gjithashtu edhe edukatat e tjera islame gjatë veshjes dhe zhveshjes së rrobave, të sandaleve apo këpucëve.


❁ Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Ruajtja dhe paralajmërimi prej shirkut dhe kundërshtimeve të Allahut, si p.sh:

Shtatë gjërat shkatërrimtare janë:

1. T'i bësh ortak (të barabartë) Allahut.
2. Magjia.
3. Vrasja e njeriut të cilin e ka ndaluar Allahu, përveç se me të drejtë.
4. Ngrënia e kamatës.
5. Ngrënia e pasurisë së jetimit.
6. Dezertimi në luftë.
7. Akuza kundër grave të ndershme, besimtare të pafajshme.

E të tjera si:

1. Mosrespektimi i prindërve.
2. Ndërprerja e lidhjeve farefisnore.
3. Dëshmia e rreme.
4. Betimet e rreme.
5. Dëmtimi i fqinjit.
6. Padrejtësia ndaj njerëzve në gjak, pasuri dhe nder.
7. Pirja e pijeve dehëse, të luajturit e kumarit (bixhozit).
8. Përgojimi, thashethemet e të tjera të cilat i ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij.



❁ Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit, namazi dhe varrosja e tij.

Tani po e sqarojmë këtë çështje shkurtimisht:

1. Duhet që kush është në prag të vdekjes të shqiptojë fjalën "LA ILAHE IL-LA ALLAH"

Thotë profeti ﷺ

« لَقْنُوا مَوْتَكُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ »

"U thoni të vdekurve tuaj të shqiptojnë "LA ILAHE IL-LA ALLAH" [Trans. Muslimi në Sahih]

Fjala 'të vdekur' në këtë hadith do të thotë: kush është në prag të vdekjes, d.m.th ata të cilëve u janë shfaqur shenjat e vdekjes.


2. Nëse dihet me siguri se ka ndërruar jetë, atëherë i mbyllet sytë sepse kjo vepër është prej sunetit.

3. I vdekuri musliman duhet të lahet dhe përjashtohet nga kjo rasti nëse është shehid (*dëshmor*) në rrugën e Allahut, sepse shehidi nuk lahet dhe nuk i falet xhenazja, por varroset me rrobat e tij sepse profeti nuk i lau të vranët në luftën e Uhudit dhe nuk ua fali xhenazet e tyre.

4. Forma e larjes së të vdekurit: Mbulimi i aures (pjesës së turpshme) të tij, pastaj ngrihet pak dhe lidhet barku i tij me një shtrëngim të lehtë. Ai i cili do ta lajë e mbështjell dorën e tij me një rrobë dhe të fillojë ta lajë me ujë e t'i japë një abdes si për namaz. Më pas ta lajë kokën dhe mjekrën e tij me ujë e sidër (gjethetë të një lloji peme) ose me diçka tjetër. Më pas t'ia lajë krahun e djathtë e pastaj të majtin. Më pas le ta lajë po në këtë formë për herë të dytë e të tretë duke e përshkuar dorën e tij mbi barkun e të vdekurit. Nëse del diçka prej organeve të tij, i lejohet të vendosë në dy vendet anale pambuk ose diçka tjetër. Nëse nuk mbyllet me atë, i lejohet përdorimi i baltës së njomë e të ngrohtë, ose me mjete të mjekësisë moderne si likoplast, etj...

Ia përsërit abdesin, e nëse nuk pastrohet me tri herë, atëherë e lan deri në pesë ose shtatë herë. Pastaj e fshin me rrobë dhe i vendos parfum në vendet që kanë më shumë nevojë për parfum, gjithashtu i vendos parfum edhe në vendet me të cilat bënte sexhden. E nëse e parfumon të gjithë trupin e tij, kjo është edhe më e mirë. Gjithashtu i tymos qefinët e tij me temjan (rrëshirë që nxirret nga disa bimë të Afrikës Lindore që lëshon tym me erë të mirë kur digjet). Nëse mustaqet dhe thonjtë e tij janë të gjata ia shkurton ato, por edhe nëse i lë ashtu si janë nuk ka problem.

Nuk i krihen flokët të vdekurit e as nuk u jepet formë atyre, nuk ia pastron vendet e turpshme nga qimet dhe as nuk e bën synet atë, sepse nuk ka ndonjë argument për këto. Kurse përsa i përket gruas, i ndan flokët e saja në tre bishta dhe i lëshon pas trupit të saj.





5. Qefinosja e të vdekurit:


Më e mira është që burri të qefinohet në tre pëlhura të bardha, duke mos patur në trup këmishë apo qeleshe ose feste, ashtu siç u veprua me profetin, duke e mbuluar me pëlhura. Nëse qefinos me këmishë, izar (*copë me të cilën mbulohet pjesa e poshtme e trupit nga mesi e poshtë*) dhe fashë nuk ka problem.

Gruaja qefinohet me pesë roba: mbulesë për trupin, mbulesë për kokën, izar dhe dy fasha. Duhet ditur se detyrë për të gjithë të vdekurit (*burra e gra*), është mbulimi me një rrobë që e mbulon të gjithë trupin e të vdekurit.

Por, nëse i vdekuri është muhrim (*me ihram në haxh*), atëherë lahet me ujë e sidër dhe qefinohet në izarin dhe ridain e tij d.m.th me ihramin e tij ose me diçka tjetër dhe nuk i mbulohet koka dhe fytyra e tij, gjithashtu nuk parfumohet, sepse do të ringjallet ai në ditën e Kiametit duke thënë telbijen siç ka argumentuar për këtë hadithi I saktë I transmetuar nga profeti. Nëse muhrimi është grua, atëherë mbulohet si të tjerat, por nuk parfumohet dhe nuk mbulohet fytyra e saj me përçe dhe as duart me dorashka, porse mbulohen fytyra dhe duart e saj me qefinin në të cilin do të qefinohet siç e sqaruam këtë në formën e qefinosjes së gruas.

Fëmija i vogël djalë mund të qefinohet nga një deri në tre pëlhura, kurse fëmija i vogël vajzë mund të qefinohet me një këmishë dhe dy fasha.

6. Ai që i takon e drejta për larje është ai i cili për të ka lënë porosi i vdekuri e më pas babai, gjyshi, e pastaj më i afërmi i tij nga trashëgimtarët dhe kjo për sa i përket burrit. Kurse për sa i përket gruas, më së pari i takon asaj gruaje për të cilën ajo ka lënë porosi e më pas nëna e saj, gjyshja e saj e më pas më e afërmja prej grave tek ajo. Bashkëshortët kanë të drejtë ta lajnë njëri-tjetrin, sepse Ebu Bekr Es-Sidik – Allahu qoftë i kënaqur prej tij – lau gruan e tij Fatimen – Allahu qoftë i kënaqur prej saj.



7. Forma e namazit të xhenazes:

Namazi i xhenazes ka katër tekbiere.


Pas tekbitit të parë lexon suren el-fatiha, e nëse lexon pas saj një sure të shkurtër ose një a dy ajete është më mirë, duke u bazuar në hadithin e saktë që është transmetuar nga Ibn Abbasi – Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Pastaj thotë tekbinin e dytë dhe bën salauat për profetin ashtu siç lexon në teshehudin e namazit. Më pas thotë tekbinin e tretë dhe thotë:

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا وَمَيِّتِنَا، وَشَاهِدِنَا وَغَائِبِنَا، وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَا، وَذَكَرْنَا وَأُنْثَانَا، اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ، وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُ، وَارْحَمْهُ، وَعَافِهِ، وَاعْفُ عَنْهُ، وَأَكْرِمْ نُزُلَهُ، وَوَسِّعْ مُدْخَلَهُ، وَاغْسِلْهُ بِلِأَمَاءٍ وَثَلَجٍ وَبَرْدٍ، وَنَقِّهِ مِنَ الذُّنُوبِ وَالْخَطَايَا كَمَا يُنْقَى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، وَأَبْدِلْهُ دَارًا خَيْرًا مِنْ دَارِهِ، وَأَهْلًا خَيْرًا مِنْ أَهْلِهِ، وَزَوْجًا خَيْرًا مِنْ زَوْجِهِ، وَأَدْخِلْهُ الْجَنَّةَ، وَأَعِذْهُ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَعَذَابِ النَّارِ، وَأَفْسَحْ لَهُ فِي قَبْرِهِ وَنُورَ لَهُ فِيهِ، اللَّهُمَّ لَا تُحَرِّمْنَا أَجْرَهُ، وَلَا تُضِلَّنَا بَعْدَهُ»

"Allahume gfireli hajjina ue mejjitina, ue shaahidina ue gaaibina, ue sagiirina ue kebiirina, ue dhekerina ue unthaana. Allahumme men ahjajtehu minna feahjihi alel Islam ue men teuefejtehu feteuffehu alel Iman. Allahumme gfirelehu uerhamhu ue a'fih i ue-'fu anhu, ue erim nuzulehu ue uessi mudkhelehu, ue gsilhu bil maai ueth-thelxhi uel beredi, ue nekkihi minel khataja kema kema juneka theubul ebjed u mined-denes, ue ebdilhu daaran hajran mik daarihi ue ehlen khajran min ehlihi, ue edkhillu elxhennete, ue eidhhu min adhabil kabr ue adhabin nar, uefsah lehu fi kabrihi ue neuuir lehu fih i. Allahumme la tehrimma exhruhu ue la tedhilna ba'dehu." Që do të thotë: "O Allah! Fale të gjallin dhe të vdekurin tonë, atë që është prezent prej nesh dhe atë që mungon. Të voglin dhe të madhin tonë, mashkullin dhe femrën tonë. O Allah! Kujt t'i japësh jetë prej nesh, jepi jetë me Islam dhe kë të vdesësh prej nesh merrja jetën me Iman. O Allah! Fale atë, mëshiroje atë, jepi kënaqësi, fale, nderojë gradën e tij, zgjeroje vendbanimin e tij, laje atë me ujë, borë dhe akull dhe pastroje atë nga gjynahet ashtu siç pastrohet rroba e bardhë prej njollave. Zëvendësoje shtëpinë e tij me një shtëpi më të mirë, dhe një familje më të mirë se familja e tij. Fute atë në xhennet dhe mbroje atë nga dënimi i varrit dhe dënimi i zjarrit! Zgjeroja varrin e tij dhe ndriçoje atë! O Allah, mos na e ndalo shpërblimin e tij dhe mos na le të humbasim pas tij."

Më pas merr tekbinin e katërt dhe jep vetëm një selam nga krahu i djathtë. Është e pëlqyeshme ngritja e duarve në çdo tekbir.

- Nëse i vdekuri është grua le të thotë: *"Allahumme gfire leha!"* që do të thotë: O Allah, fale atë grua! Nëse xhenazja përbëhet nga dy të vdekur, thuhet: *Allahumme, gfire lesuma!* Që do të thotë: O Allah, fali ata të dy! Dhe nëse xhenazet janë shumë, atëherë themi: *Allahumme, gfire lehum!* O Allah, fali ata!



- Nëse xhenazja është fëmij, në vend të kërimit të faljes për të themi:

"Allahumme, ixhalhu faratan ue dhekhran li ualidejhi, ue shefian muxhaaba. Allahumme thekkil bihi meuaziinehuma ue e'dhim bihi uxhuurahumae elhikhu bisalihil selsefil mu'minin ue xhealhu ue xhealhu fi kefaleti Ibrahim alejhi salatu ues-salam ue kihi birahmetike adhabel xhehim!" që do të thotë:

"O Allah! Bëje atë paraprirës e mbështetje dhe rezervim për prindërit e tij! Bëje atë ndërmjetës të pranueshëm! O Allah! Rëndoji me anë të tij peshoret e prindërve të tij, shtoji me anë të tij shpërblimet e tyre! Bëje të mundur të arrijë gjeneratat e para të besimtarëve! Vendose atë nën kujdesin e Ibrahimit, paqë dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të - dhe mbroje atë me mëshirën tënde nga dënimi i zjarrit!"

- Nga suneti është që imami të qëndrojë në drejtim të kokës nëse i vdekuri është burrë dhe në mes të trupit nëse i vdekuri është grua. Nëse janë shumë xhenaze, atëherë para imamit të jetë burrë, kurse gruaja të qëndrojë në anën e kiblës. Nëse midis xhenazeve ka edhe fëmijë, atëherë fëmija i vogël (djalë) vendoset para gruas. Koka e fëmijës së vogël vendoset në drejtim të kokës së burrit dhe në mes të trupit të gruas në drejtim të kokës së burrit. Po kështu edhe nëse fëmija i vogël është vajzë, koka e saj vendoset në drejtim të kokës së gruas, kurse mesi i saj në drejtim të kokës së burrit. I gjithë xhemati që do të falet duhet të qëndrojë pas imamit dhe vetëm nëse ndonjëri nuk gjen vend, atëherë le të qëndrojë në krahun e djathtë të imamit.


8. Forma e varrosjes së të vdekurit:

Të hapet varri me thellësi deri tek mesi i burrit dhe të hapet brenda tij lahdi në anën e kiblës dhe të vendoset i vdekuri në lahd në krahun e tij të djathtë. Më pas të zgjidhet kordelja (me të cilin u lidh qefini) e të mos hiqet por të lihet ashtu.

Të mos zbulohet fytyra e tij qoftë i vdekuri burrë apo grua. Më pas vendosen mbi të tulla të shoqëruara me llucë me qëllim që të fiksohet e të ruajë baltën. Nëse nuk ka mundësi të gjenden tulla, le të mbyllet me diçka tjetër si beton gurë ose dërrasë me qëllim që të ruajë baltën. Më pas le të hidhet mbi të dheu dhe këtu është e pëlqyeshme të thuhet:

« بِسْمِ اللَّهِ ، وَعَلَى مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ »

"Bismilah ue ala mileti rusulil-lah."





Të ngrihet varri sa një pëllëmbë dhe nëse ka mundësi le të vendosen mbi të gurë të vegjël e të hidhet mbi të pak ujë.

Është nga suneti i profetit që ata të cilët e përcjellin xhenazen të qëndrojnë tek varri dhe të luten për të vdekurin, sepse pejgamberi pasi varrosej plotësisht i vdekuri qëndronte aty dhe thoshte: *"Kërkoni falje për vëllain tuaj dhe kërkoni për të qëndrueshmëri, sepse ai tani pyetet."*

9. Gjithashtu është nga suneti që ai që nuk e ka falur namazin e xhenazes, ta falë atë pas varrimit, sepse profeti e ka vepruar një gjë të tillë. Kjo gjë bëhet kur diferenca e kohës së varrimit është më pak se një muaj dhe nëse diferenca kohore është më e madhe se kaq, atëherë nuk është prej sunetit që të falet tek varri, sepse nuk ka ardhur ndonjë argument që profeti është falur tek varri një muaj pas varrimit të të vdekurit.

10. Nuk lejohet që pjesëtarët e familjes së të vdekurit të përgatisin ushqim për njerëzit.

Thotë sahabiu i nderuar Xherir bin Abdilah el-Bexheli:


"Grumbullimin e njerëzve tek familja e të vdekurit dhe përgatitjen e ushqimit ne e quanim prej vajtimit." [Trans. Imam Ahmedî me zinxhir transmetimi të mirë]

Nuk ka problem nëse përgatisin ushqim për veten e tyre dhe për miqtë, por është e pëlqyeshme që të afërmit dhe fqinjët e tyre të përgatisin ushqim për ta, sepse profeti kur i erdhi lajmi për vdekjen e Xha'fer bin ebi Talibit - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - në Sham urdhëroi familjen e tij që të përgatisin ushqim për familjen e Xha'ferit dhe tha: *"Atyre u erdhi diçka që i ngarkoi."*

Nuk ka problem për familjarët e të vdekurit nëse thërrasin fqinjët e tyre apo njerëz të tjerë për të ngrënë nga ushqimi i cili u është dhuruar atyre dhe kjo gjë nuk ka ndonjë kohë të caktuar në bazë të dijes që kemi nga sheriat.

11. Nuk lejohet që gruaja të mbajë zi për të vdekurin më tepër se tre ditë. Këtu bëhet përjashtim nëse i vdekuri është burri i saj, ajo e ka detyrë të mbajë zi për atë katër muaj e dhjetë ditë, e nëse është shtatëzanë atëherë e zgjat kohën e zisë e saj derisa të lindë, sepse me këtë gjë ka ardhur suneti i saktë nga pejgamberi.

- Kurse për sa i përket burrit, atij nuk i lejohet të mbaj zi për asnjë nga të afërmit dhe për askënd tjetër.





12. Nga Suneti i profetit është që burrat t'i vizitojnë varret herë pas here me qëllim që të bëjnë lutje për ta, të kërkojnë mëshirë për ta dhe për të kujtuar vdekjen dhe ndodhitë pas saj. Për këtë argumenton fjala e profetit ku thotë:

« زُورُوا الْقُبُورَ، فَإِنَّهَا تُذَكِّرُكُمُ الْآخِرَةَ »

"Vizitojini varret, sepse ato ju bëjnë të kujtoni botën tjetër."

[Trans. Imam Muslimi në Sahihun e tij]

Profeti i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varret të thoshin:

« السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُسْلِمِينَ وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ ، أَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمْ الْعَافِيَةَ، يَرْحَمُ اللَّهُ الْمُسْتَقْدِمِينَ مِنَّا وَالْمُسْتَأْخِرِينَ »


"Es-selamu alejkum ehle dijari minel mu'minine uel muslimine ue inna insheAllahu bikum laahiku. Nes'elu Allah lena ue lekumul aafijete, jerhamu Allahu el-mustekdimine minna uel muste'khirine."


Kuptimi i kësaj lutje është: *"Paqja e Allahut qoftë mbi ju, O banorët e këtij vendi besimtarë e muslimanë. Edhe ne me urdhërin e Allahut, insheAllahu me ju do të radhitemi. Lusim Allahun të na falë ne dhe juve. Allahu i mëshiroftë të parët e të mbramët tanë."*

Për sa i përket grave, nuk lejohet që ato t'i vizitojnë varret, sepse profeti i ka mallkuar ato gra që vizitojnë varret, sepse vizita e tyre në varre është mospërmbajtje dhe vajtim.

Gjithashtu nuk u lejohet atyre të përcjellin xhenazet në varre, sepse profeti i ka ndaluar ato nga kjo gjë. Kurse namazi i xhenazes në xhami ose në faltore është nga suneti të kryhet nga burrat dhe gratë.


Këtu u erdhi fundi këtyre mësimeve. Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi pejgamberin tonë, Muhammedin, mbi familjen dhe shokët e tij.





Pyetjet

Përse e mësojmë librin "Mësime të rëndësishme"	1.		2.	
Autori i librit është:				
Mënyra sesi mësohet Kur'ani rregullisht.				
Në cilat libra të tefsirit duhet të mësojmë.				
Kushtet e fjalës La ilahe il-lAllah.	1.	2.	3.	4.
	5.	6.	7.	8.
Shembuj nga shirku i madh.				
Shembuj nga shirku i vogël.				
Kushtet (<i>shurutet</i>) e namazit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	
Kur llogaritet fëmija që ka arritur fazën e të dalluarit.				
Largimi i papastërtisë është dy llojesh.	1.	2.		
Llojet e aurretit.				
Shtyllat (<i>ruknet</i>) e namazit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	
	10.	11.	12.	
	13.	14.		
Kush konsiderohet si i pamundur që të qëndrojë në këmbë (<i>kijam</i>).	1.		2.	
Obligimet e namazit.	1.	2.	3.	4.
	5.	6.	7.	8.






Forma e teshehudit.				
Sunetet e namazit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	
	10.	11.	12.	
	13.	14.		
Momentet në të cilat lexohen duatë.	1.		2.	
Gjërat që prishin namazin.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.		
Lëvizjet në namaz, sill shembull për secilën prej tyre.	1.	2.	3.	
	4.		5.	
Shkaqet për të bërë sexhden e harresës.	1.	2.	3.	
Llojet e dyshimit.	1.		2.	
Llojet e dyshimit në namaz.	1.		2.	
Kushtet e abdesit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.
Gjykimi i nijetit në abdes.				
Obligimet e abdesit.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
Gjërat që e prishin abdesin.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
Si merret tejemumi.				






Si merret gusuli i detyruar.				
Si merret gusuli i pëlqyer.				
Si falet namazi i xhenazes.				
Vizitat e lejuara në Medine.	1.	2.	3.	
	4.	5.		
Prej moralit të mirë që na ka urdhëruar sheriati.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.
Prej edukatës Islame.	1.	2.	3.	
	4.	5.	6.	
	7.	8.	9.	10.

Vepra	Gjykimi	Vepra	Gjykimi
Shirku i madh.		Shirku i vogël.	
Shirku i fshehtë.		Namazi i jobesimtarit.	
Namazi i të çmendurit.		Namazi i fëmijës.	
Falja pa abdes nga harresa.		Falja e namazit ndërsa tek ai gjendet papastërti.	
Drejtimi nga Kibla.		Falja me gjunjë të zbuluar.	
Falja pasi ka dalë koha.		Namazi në makinë.	



Bërja e nijetit me zë.		Namazi ulur.	
Leximi i fatihas në çdo rekat.		Teshehudi në namaz.	
Salavatet Ibrahimije.		Namazi nafile shtrirë.	
Leximi i Kur'anit në sexhde.		Të folurit në namaz.	
Levizja e shikimit.		Shtimi i një rekati në namaz.	
Lenia e një shtylle të namazit kur je me imam.		Dëgjon zë prej barkut (Gërritje e zorrëve).	
Dyshimi në abdes gjatë namazit.		Dyshimi në mes të namazit.	
Dyshimi se kemi lënë ndonjë shtyllë mbasi ka përfunduar namazi.		Harresa « Rabi gfirli »	
Harresa e teshehudit të parë pasi ai është ngritur.		Harresa e tekbitit fillestar.	
Gjen imamin ne ruku dhe nuk lexon fatihan.		Të bësh nijetin për të prish abdesin, më pas nuk e prish porse vazhdon namazin.	
Të bësh nijet për të prish abdesin, porse nuk e prish atë.		Abdesi para pastrimit nga nevoja.	
Abdesi pas ngrënies së mishit të devesë.		Larja e kërcirit gjatë abdesit.	
Abdesi i atij që ka në dorën e tij mbetje brumi.		Larja e mjekrrës.	
Larja e veshëve me uje të ri.		Larja e pjesëve të abdesit më shumë se tre herë.	
Larja e pjesëve të abdesit vetëm njëherë.		Fërkimi i kokës me ujë më shumë se tre herë.	
Larja e duarëve para abdesit.		Larje e të vdekurit a e prish abdesin ?	
A e prish abdesin përgjumja, kotja.		Namazi pas notimit.	






Falja pasi ke marrë gusul, pa marrë abdes.		Pastrimi nga urina e vajzës së vogël.	
Pastrimi nga urina e djalit të vogël.		Lenia e një tekbiri nga namazi i xhenazes.	
Vizita e grave në varreza.		Vizita e dëshmorëve të Bedrit.	
Vizita e varrit të profetit.			

Dallimi mes kushtit (shert)	Shtyllës (rukn)	Obligimit (uaxhib)	Sunnetit





Përmbajtja:

Hyrja.....	2
Edukata e nxënësit të dijes	4
Shpjegimi i Tri Parimeve	7
Llojet e lutjes (<i>du'a</i>).....	11
Llojet e frikës (<i>el-khauf</i>)	11
Llojet e kurbanit (<i>dhebh</i>)	12
Llojet e zotimit (<i>nedhr</i>).....	12
Shpjegim i shtyllave të besimit	13
Tri Parimet	15
Pyetjet.....	35
Shpjegimi i Katër Rregullave	39
Llojet e ndërmjetësimit (<i>shefa'a</i>)	42
Katër Rregullat.....	43
Rregulli i parë.....	45
Rregulli i dytë.....	45
Rregulli i tretë.....	46
Rregulli i katërt	48
Pyetjet.....	49
Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë	54
Mësimi i parë.....	54
Mësimi i dytë: Shtyllat e Islamit.....	54
Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit (besimit).....	55

Mësimi i katërt: Llojet e teuhidit dhe shirkut	55
Mësimi i pestë: Ihsani (Bamirësia)	59
Mësimi i gjashtë: Kushtet e namazit	59
Mësimi i shtatë: Ruknet (shtyllat) e namazit	59
Mësimi i tetë: Detyrat e namazit	60
Mësimi i nëntë: Forma e teshehudit e transmetuar nga profeti	60
Mësimi i dhjetë: Sunetet e namazit	62
Mësimi i njëmbëdhjetë: Gjërat që prishin namazin	63
Mësimi i dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit.....	63
Mësimi i trembëdhjetë: Obligimet e abdesit	63
Mësimi i katërmëdhjetë: Gjëra që e bëjnë të pavlefshëm abdesin.	64
Mësimi i pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralin që na ka urdhëruar sheriati.....	64
Mësimi i gjashtëmbëdhjetë: Edukimi me edukatë Islame si:.....	65
Mësimi i shtatëmbëdhjetë: Ruajtja dhe paralajmërimi prej shirkut.....	65
Mësimi i tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit, namazi dhe varrosja e tij.....	66
Pyetjet.....	73
Përmbajtja	79





Jsmet Hyseni